

Kandidatët për Anëtarësim

Roli Juaj si Ministre/Minister e/i Punëve të Jashtme të një vendi që dëshiron të anëtarësohet

Fragment nga premambula e marrëveshjes mbi BE-në sipas veriantit të Nisës:

(...) TË VENDOSUR, të ngrenë në një nivel të ri procesin e integritimit evropian inicuar me themelimin e Komunitetit evropian, DUKE U NISUR nga rëndësia historike e kapërcimit të ndarjes së kontinentit evropian dhe domosdoshmëria e krijimit të bazave ta forta për trajtën e Evropës në të ardhmen, DUKE KONFIRMUAR vlefshmërinë e parimeve të lirisë, demokracisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut e të lirive themelore, dhe parimit të shtetit ligjor, (...)
ME DËSHIRËN për të përforcuar më tej demokracinë dhe efikasitetin në veprimtarinë e organeve, me qëllim që këto të jenë në gjendje të realizojnë edhe më mirë detyrat e ngarkuara brënda një kuadri të njësuar institucional, (...)
TË VENDOSUR për të vazhduar më tej procesin e krijimit të një unioni gjithnjë e më të ngushtë të popujve të Evropës, ku vendimet të merren sipas parimit të subsidiaritetit duke qenë mundësisht sa më afër qytetarit, DUKE PATUR PARASYSH që duhen bërë hapa të tjerë për të çuar përpara integritimin evropian, VENDOSËN të themelojnë Bashkimin Evropian (...)

Ndryshimet rrënjësore në Evropën Lindore në fund të viteve tetëdhjetë, rritën ndjeshëm presionin mbi Bashkimin Evropian për të vazhduar zgjerimin dhe për t'u hapur shtetve të Evropës Juglindore një perspektivë anëtarësimi.

Fillimisht Komuniteti Evropian u gjend pak i ngathët përballë ndryshimit të sistemit në Evropën Lindore. Ai nuk ishte i përgatitur për ndryshimet e atjeshme dhe për pasojat politike dhe ekonomike direkte që do të kishte për Komunitetin.

Por megjithatë Bashkimi Evropian reagoi duke krijuar programe të ndryshme ndihme në mbështetje të proceseve të transformimit dhe të përafrimit të këtyre vendeve me BE-në. Programi PHARE, i menduar fillimisht vetëm për Poloninë dhe Hungarinë u shtri më vonë në të gjithë vendet e tjera kandidate të Evropës Lindore dhe Qëndrore. Ndërkaq programi PHARE është programi kryesor financiar për mbështetjen e vendeve kandidate. Programe të tjera

janë ISPA (Masa për ndërtimin e infrastrukturës në sektorin e mjedisit dhe bujqësisë) SAPARD (Masa në strukturimin e sektorit të bujqësisë).

Në kuadër të strategjisë për përafrim, procesi që mundëson anëtarësimin e vendeve kandidate kalon nëpër shumë etapa. Një hap i ndërmjetëm janë Marrëveshjet me Evropën të cilat parashikojnë zonën e tregut të lirë shoqëruar nga një dialog politik dhe mbështetje ekonomike duke u hapur kështu shteteve që dëshirojnë të bëhen pjesë e BE-së, një perspektivë për anëtarësim në një moment të dytë.

Në fillim të shekullit të ri, grupi i vendeve kandidate për anëtarësim, duke qenë se tashmë 12 shtete janë antarësuar, përbëhet momentalisht vetën nga pak shtete. Megjithatë interesi i këtyre vendeve për një anëtarësim në BE nuk rresht. Gjithmonë e më shumë vende të Evropës Juglindore si Kroacia dhe Turqia shprehin dëshirën për bashkëpunim dhe kërkojnë lidhje me Bashkimin Evropian.

Vendet që kërkojnë të anëtarësohen nuk janë një grupim homogjen. Situata e reformave politike dhe ekonomike në Evropën Juglindore është shumë e ndryshme. Por qëllimi i

përbashkët më i rëndësishëm i këtyre vendeve është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, pikërisht siguria e një perspektive të qartë antarësimi në një të ardhme jo të largët.

Si Ministre/Ministër i Punëve me Jashtë i një vendi që dëshiron të anëtarësohet, Ju jeni koshient se për sa i përket vazhdimësisë së procesit të reformave ekonomike, përforcimit të strukturave administrative si dhe atyre në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve, duhet ende të ndërmerrni përpjekje për të arritur standartet e BE-së. Vini theksin veçanërisht në mënyrë të qartë mbi hapat që vendi juaj tashmë i ka përmbyllur.

Njëkohësisht jeni në dijeni se ngadalësimi i procesit të zgjerimit është në interes të disa vendeve antare të Bashkimit. Për këtë arsye, gjatë prezantimit tuaj në Këshill vini theksin mbi domethënien e një Evrope të bashkuar dhe mbi domosdoshmërinë për të kapërcyer ndarjen e kontinentit çka vendet anëtare të Bashkimit Evropian e kanë marrë përsipër në Marrëveshjen e Amstërdamit (shih kutinë). Flisni edhe për përfitimin dypalësh të një zgjerimi të përsheptuar.

Si Ministre/Ministër i Punëve me Jashtë, Ju përfaqësoni natyrisht gjithmonë interesat e vendit tuaj por është e dobishme dhe e rëndësishme mbajtja e vazhdueshme e kontakteve me kolegët e shteteve të tjera kandidate dhe kërkimi i një strategjie të përbashkët për ti kushtuar çështjes së anëtarësimit të shpejtë në BE vemendjen dhe peshën e duhur në Këshillin e Bashkimit dhe Parlamentin Evropian.

Për të realizuar shansin e një anëtarësimi të shpejtë keni në dispozicion mjete të cilat mund ti shfrytëzoni sipas vlerësimit tuaj:

- Ju mundoheni të vendosni kontakt informal me Ministren/Ministrin e një shteti antar i cili mbështet kërkesën tuaj për anëtarësim dhe që mund të shpjerë përpara çështjen tuaj në Këshillin e Bashkimit Evropian;
- Me mjeshtëri diplomatike Ju mund të zgjidhni konflikte ekzistuese (p.sh. mosmarrëveshje në çështjen e kufijve me vende të tjera) ose probleme të vendit tuaj dhe në këtë mënyrë të argumentoni anëtarësimin tuaj për përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit;
- Gjatë prezantimit tuaj në Këshillin e Bashkimit mos humbni qetësinë për shkak të epërsisë numerike;
- Mundohuni të influenconi përfaqësuesit e shtypit për të pasqyruar pozitivisht vendin tuaj në media.

Kujtesë: Si mund të behet një shtet anëtar i Bashkimit Evropian?

Neni 49 (ish neni O) [Pranimi i shteteve të tjera antare]

„Çdo shtet evropian [...] mund të bëjë kërkesën për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Kërkesa i dorëzohet Këshillit, i cili duhet të vendosë njëzëri pasi ka dëgjuar Komisionin dhe ka marrë miratimin e Parlamentit Evropian, i cili merr vendimin e vet me shumicë absolute (*shënimi i autorit :më shumë se 50% e të gjithë deputetëve*).”

Detya juaj si e/i deleguar i një vendi që kërkon të anëtarësohet:

1. Përshtatuni me rolin tuaj specifik; gjatë fjalës përshëndetëse të Presidentit të Komisionit keni mundësinë për të vendosur kontaktet e para informale.
2. Me ndihmën e kërkesës për pranim (Krahaso kap. V-M5) formuloni një propozim për anëtarësim.
3. Propozimin tuaj për anëtarësim dorëzohani personalisht Kryetares/Kryetarit të Këshillit të Bashkimit Evropian.

4. Kryeni një bisedë informative tek Komisioni Evropian; zhvilloni një strategji dhe taktikë për bisedimet e rradhës; drejtoni një konferencë shtypi dhe përpunoni një deklartë për shtyp mbi vendin tuaj (krahaso kap.V-M10.) të cilin ia shpërndani përfaqësuesve të shtypit.
5. Prezantoni Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit për Punët me Jashtë pranë Parlamentit Evropian kërkesën tuaj për anëtarësim.
6. Drejtoni së bashku me Komisionin bisedimet për anëtarësim.
7. Brënda mundësive jeni i ftuar të asistoni gjatë votimit në Këshillin e Bashkimit Evropian dhe në Parlamentin Evropian.
8. Përgatisni një fjalim për konferencën e pranimit që do të vijojë.
9. Gjatë festimeve në konferencën e pranimit mbani një fjalim të shkurtër (dy minuta) dhe në përfundim të saj qëndroni gati për të dhënë intervista të mundshme ose të merrni pjesë në emisione televizive.

Vendi	sipërfaqja në km²	Nr. i banorëve	Të ardhurat neto / banor	Papunësia %	Inflacioni %	Rritja ekonomike %	Monedha
Shqipëria	28.748	3.150.000	2.570	13,8 (2006)	2,5 (2006)	3,5 (2005)	1 Lek = 100 Qindarka
Bosnje-Hercegovina	51.129	3.907.000	2.700	k. A.	1,0 (2005)	5,0 (2005)	1 Konvertible Mark = 100 Fening
Kosova	10.887	1.900.00	k. A.	35 - 50	0,5 (2005)	k. A.	10 Euro = 100 Cent
Kroacia	56.542	4.443.000	8.290	11,8 (2006)	3,2 (2006)	4,3 (2005)	1 Kuna = 100 Lipa
Maqedonia	25.713	2.034.000	2.830	36,0 (2006)	2,9 (2006)	4,0 (2005)	1 Denar = 100 Deni
Mali i Zi	13.812	608.000	3.220	32,5 (2005)	15,2 (2005) ¹	4,7 (2005) ¹	1 Euro = 100 Cent
Serbia	88.361	9.863.000	3.220	20,9 (2006)	12,7 (2006)	4,7 (2005)	1 Neuer Dinar = 100 Para
Turqia	779.452	72.065.000	4.750	9,9 (2006)	9,9 (2006)	7,4 (2005)	1 Neue Lira = 100 Kurus

¹ së bashku me Serbinë

Shqipëria

Kryeqyteti:	Tirana
Forma shtërore:	Republikë
Sipërfaqja:	28.748 km ²
Banorë:	3,172 Mil.
PBB/banor:	2.930 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	5,0%
Papunësia:	13,2%
Gjuha:	shqip
Besimi fetar:	70% muslimanë, 20% ortodoksë të krishterë, 10% katolikë
Grupet etnike:	95% shqipatrë, minoritetet maqedonas, grek etj.
Kryertar shteti:	Bamir Topi
Kryetar qeverie:	Sali Berisha
Informacione të mëtejshme:	www.botschaft-albanien.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni e/i deleguar i Shqipërisë gjatë bisedimeve me BE-në. Ju synoni anëtarësimin e shpejtë të vendit tuaj në BE. Gjatë bisedimeve mund të shfrytëzoni të dhënat e mëposhtme nga historia, politika dhe ekonomia e vendit tuaj. Natyrisht Ju lejohet të fshihni ose të përmirësoni disa të dhëna pak të këndshme. Mos harroni se qëllimi Juaj është anëtarësimi i shpejtë i vendit Tuaj në Bashkimin Europian!

Shqipëria/Albania (shqip: *Shqipëri/Shqipëria* oder *Republika e Shqipërisë*) është një shtet në Evropën Juglindore. Ajo kufizohet në veri me Kosovën, Malin e Zi, në lindje me Maqedoninë si dhe në jug me Greqinë. Kufiri natyral perëndimor krijohet nga bregdeti i detit Adriatik dhe Jon duke e bërë vendin pjesë të grupit të vendeve fqinj të Mesdheut. Vendi është anëtar i Kombeve të Bashkuarar dhe i Këshillit Evropian. Në datë 3 prill 2008, Shqipëria morri ftesën për anëtarësim në NATO.

Me nje sipërfaqje prej 28.748, Shqipëria është diçka më e vogël se Belgjika dhe me rreth 3,2 Mln. banorë më pak e populluar se rajoni i Berlinit.

Shqipëria ka një linjë bregdetare të gjatë 362 km për gjatë Adriatikut dhe Jonit me shumë rërë dhe plazhe ranore. Vënde të njohura pushuese janë Durrësi, Vlora, Shëngjini, Velipoja në detin Adriatik si dhe Himara, Dhërmiu dhe Saranda në detin Jon. Në jug, (ngushtica e Otrantos) bregedi shqiptar ndodhet vetem 71 km larg atij italian.

55% e popullsisë shqiptare jeton në zonat rurale. Parë nga pikëpamja etnike, Shqipëria është pas Greqisë (93%) shteti më homogjen i Ballaknit: 90 përqind e popullsisë është shqiptare. Në jug të vendit jeton një minoritet i madh grek. Grupe të tjera minoritare janë maqedonasit sllavë në zonat lindore kufitare si dhe romët dhe arumunët.

Shqiptarët ndahen në dy grupe, gegë dhe toskë të cilët ndryshojnë nga njëri tjetri jo vetëm nga pikëpamja gjuhësore por edhe kulturore. Ndërsa toskët e gjysmës jugore të

vendit u ndikuan shumë nga kultura qytetare e Perandorisë Osmane, në pjesën veriore të gegëve jeta e njerëzve deri në shekullin e 20-të mizotërohej nga një kulturë fisnore arkaike. Përrjashtim përbën këtu qyteti i rëndësishëm verior i Shkodrës i cili deri pas shekullit të 15-të ishte i pushtuar për kohë të gjatë nga venedikasit. Katolicizmi dhe lidhjet me Italinë kanë ndikuar edhe në vitet e mëvonëshme mentalitetin e banorëve. Edhe pas procesit të urbanizimit dhe industrializimit gjatë periudhës komuniste dhe deri në vitin 1990 pjesa më e madhe e banorëve jetonte në zonat rurale.

Ky fakt ka influencuar mentalitetin e shumë njerëzve edhe në qytet pasi edhe në qoftë se ata nuk kanë arrdhur vetë, kanë qënë prindrit e tyre që janë shpërngulur ose kanë familjarë të afërt që jetojnë ende nga prodhimtaria e vogël bujqësore. Borgjezia qytetare ka qënë fenomen i rrallë në Shqipëri. Një kulturë qytetare moderne është vënë re në fillimet e shekullit të 20-të vetëm në qytetet e Shkodrës, Korçës dhe Gjirokastrës. Në vitet njëzetë u shtua edhe Tirana për shkak të funksionit si kryeqytet.

Komunistet nuk e pranuan ndërgjegjshëm qytetare të këtyre qyteteve dhe vazhduan të shkatëronin edhe pas vitit 1945 verprat kulturore qytetare.

Periudha pas ndryshimeve të viteve 90-të solli me vete levizje të mëdha demografike. Nga njëra anë qindra mijëra shqiptarë emigruan legalisht dhe ilegalisht për në Itali, Greqi, vende të tjera të BE-së si dhe në Amerikën e Veriut, nga ana tjetër kryeqyteti Tirana dhe qyteti me portin më të madh, Durrësi njohën një rritje të madhe të popullsisë si pasojë e emigrimit të brenshëm (Tirana nga 250.000 banorë në vitin 1990 numuron sot më shumë se 600.000).

Zonat rurale ashtu si edhe jo pak qyteza u braktisën. Në vitet në vijim shumë fshatra të tjerë do të ktheheshin në shkretëtira. Në qoftë se deri para vitit 1990 Shqipëria kishte shkallën më të lartë të lindjeve në Evropë, (mjetet parandaluese ishin të ndaluara) sot kjo është ulur duke arritur mesataren evropiane ku përlogaritet për grua më pak se dy femijë. Kjo situatë si dhe shpërnguljet e motivuara shkaktojnë një plakje të shpejtë të popullsisë shqiptare edhe pse për sa i përket brezit nga 15-30 vjeç shumë i pranishëm, nuk është ende fort e ndjeshme.

Që prej vitit 1968 deri 1990 komunistët e kishin deklaruar Shqipërinë shtet ateist dhe ndalonin çdo lloj ushtrimi të fesë. Ashtu edhe si më parë, shumica e shqiptarëve nuk kanë dhënë asnjë deklaram zyrtar në lidhje me përkatësinë fetare. Megjithatë ata e dinë nëse familja e tyre rrjedh nga trdita myslymane, ortodokse apo katolike. Shqiptarët numurojnë rreth 40% sunitë, 20% bektshinj, 20% të tjerë ortodoksë të krishterë dhe rreth 10% katolikë. Pjesa që mbetet, rreth 10% i përkasin besimeve të tjera- veçanërisht Kishës së lirë.

Para Luftës së Dytë Botërore 70% e popullsisë ishte deklaruar si sunitë islame. 20% si ortodoksë të krishterë, këtu përmbledheshin edhe minoritetet etnike. Rreth 10% i përkisnin kishës katolike-romake. Shqiptarët ortodoksë jetonin pothuajse në jug, katolikët në veriperëndim ndërsa myslymanët përveç disa zonave malore jetonin kudo në vend.

Në qoftë se do të lireshin jashtë vëmendjes të gjithë atë që nuk janë deklaruar në lidhje me përkatësinë e tyre fetare, raportet do të ktheheshin në favor të Kishës Perëndimore. Nga njëra anë shumë katolikë ruajtën besimin e tyre edhe në kohën e përndjekjeve komuniste çka i mundësoi Kishës Katolike, pas vitit 1990 me ndihmë italiane një riorganizim më të lehtë. Nga ana tjetër shumë njerëz zgjodhën të bëheshin të krishterë pasi nga pikëpamja kulturore qëndon më afër perëndimit. Në këtë mënyrë jo vetëm

Kisha Katolike u rrit në besimtarë por edhe kishat protestante aktive në vend dhe bashkësitë besimtare rritën numrin e aktivistëve të tyre. Nga ana tjetër edhe Kisha shqiptare Ortodokse që prej vitit 1991 veçanërisht nga puna e Kryepeshkopit Anastas Janullatos ka njohur dyndje të mëdha. Më pak dinamik ka qënë zhvillimi i islamit. Edhe pse Arabia ka ndihmuar shumë dhe u ndërtuan xhami të panumërta, qëndrimi i ashpër i ndihmësve arabë nuk gjeti rezonancë të madhe tek shqiptarët, e njëjta gjë i ndodhi edhe përpjekjeve misionare të Mullahut shiit nga Irani.

Ashtu si edhe në kohrat përpara se besimi fetar të ndalohej, akceptanca dhe toleranca e ndërsjelltë ndërmjet besimeve të hershme është shumë e lartë. Festat fetare festohen sëbashku dhe kryen vizita në monumente kult të komuniteteve të tjerë. Lidhjet martesore midis të krishterëve dhe myslymanëve që prej epokës komuniste nuk përbëjnë problem dhe janë në rend të ditës në Shqipëri.

Minoritetet etnike dhe vendndodhjet e tyre

Grekët

Grekët panvarsisht shpenguljeve me qëllim emigrimi drejt Greqisë mbeten me 105.000 antarë (3,2%) minoriteti më i madh i Shqipërisë. Grekët jetojnë në jug të Shqipërisë, në rrethin e Sarandës, Gjirokastrës dhe Vlorës. Grekët janë njohur zyrtarisht që në epokën komuniste si grup etnik dhe as në Shqipërinë e sotme nuk vuajnë nga ndonjë disfavor. Ata kanë shkollat e tyre (për aq kohë sa numri i nxënësve është i mjaftueshëm për të formuar një klasë në gjuhën greke), në Universitetin e Gjirokastrës ofrohet dega e gjuhës greke, ekzistojnë stacione radiofonike në gjuhën greke si dhe komunikimi në greqisht me zyrtarë lokale është i mundur.

Si rrjedhojë edhe shpërnguljet e tyre kanë shpesh për motiv situatën e rëndë ekonomike. Që prej viteve 1990 duhet theksuar se në jug të Shqipërisë gjithnjë e më shumë njerëz deklarohen si grekë dhe madje ndërrojnë emrin e tyre myslyman me një emër të krishterë. Kjo shpjegohet me faktin se grekët etnikë e kanë më të lehtë të marrin një vizë udhëtimi për në vendin fqinj të BE-së.

Romët

Të dhëna zyrtare mbi numrin e romëve nuk ekzistojnë por sipas vlerësimeve në Shqipëri jetojnë rreth 90.000 dhe 120.000 romë (3%). Ata jetojnë të shpërndarë në gjithë vendin. Shumica e këtij grupi popullor jeton në varfëri edhe pse shtetet e Evropës Juglindore janë zotuar të përmirësojnë situatën arsimore, shëndetësore, atë të punësimit dhe të banimit të romëve.

Serbët, malazezët dhe goranët

Grupe të vogla serbe ose më mirë malazeze jetojnë në rajonin në veri të Shkodrës. Numri i saktë nuk dihet. Por për arsye asimilimi në kohën ndërmjet luftërave ai është ulur në disa mijëra. Njëkohësisht deri në mesin e viteve 30-të ekzistonin një numër shkollash fillore kishtarë të cilat zhvilloheshin në serbisht. Qeveria shqiptare për dhjetëvjeçarë me rradhë nuk i ka njohur minoritetet sllave dhe pas Luftës së Dytë Botërore vazhdoi asimilimin. Vetëm në vitin 2004 Qeveria shqiptare njohu zyrtarisht ekzistencën e minoritetit malazez dhe serb.

Maqedonasit

Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1989 ekzistonin në Shqipëri 4.697 maqedonas. Shumica e tyre jeton në komunën pranë Liqenit të Prespës i cili pjesërisht i përket edhe Maqedonisë dhe Greqisë. Rreth 4.000 banorët e komunës janë pothuajse të gjithë sllavë. Ata kanë shkollat e tyre; ndër të tjera, në fshatin kresor të komunës ndodhet edhe i

vetmi gjimnaz i Shqipërisë në gjuhën maqedonase. Grupime të vogla sllave ka edhe në rrethinat e Korçës, Pogradecit, në qytetin qëndror të Shqipërisë Elbasan, në Tiranë si dhe në fshatrat e Peshkopisë dhe Maqellarës në afërsi të kufirit më Kosovën dhe Maqedoninë. Sot numri i maqedonasve në Shqipëri nuk është më i madh se 20.000.

Aromunët

Aromunët (të quajtur edhe vllenj) jetojnë në grupe të vogla kudo në Shqipëri. Zonë me popullsi të madhe aromune është në rradhë të parë Korça aty ku ndodhet edhe Kisha e tyre e madhe ortodokse dhe jo shumë larg Voskopoja e cila deri në shekullin e 18-të ishte qendra e aromunëve. Një pjesë e tyre jeton edhe në Tiranë dhe Elbasan. Mbi numrin e tyre në total nuk ka të dhëna të sigurta; ai lëkunder nga 10.000 deri 100.000.

Gjurmët e para të vendbanimeve njerëzore në territorin shtetëror të Shqipërisë së sotme janë 100.000 vjet të vjetra. Rreth vitit 1000 p.e.s., ilirët pushtuan Ballkanin Perëndimor. U mundësua formimi i disa pernadorigëve të fiseve të veçantë, si Pernadorigët e Labeatëve e cila ekzistoi nga 380 deri 168 p.e.s. Qytete rezidente ishin Shkodra dhe Risani. Pas luftërve ilire, Ballkani Perëndimor rra në fund të shekullit të 3-të p.e.s. nën influencën romake duke nisur romakëzimin e ilirëve.

Me ndarjen e Perandorisë Romake në vitin 395, Shqipëria e sotme rra nën pushtimin bizantin. Në vitin 591 pati shpërngulje sllave nga veriu drejt këtij rajoni të shoqëruara me plaçkitje kudo në Ballkan. Nga 880 deri 1018, Shqipëria Qëndrore dhe Jugore u bënë pjesë e Perandorisë Bullgare. Në vitin 1081 qenë normanët që u sulën drejt Shqipërisë të pushtuar nga Bizanti.

Pas rënjes së Perandorisë Bizantine si pasojë e Kryqëzatës së katërt (1204), sundimi mbi trojet e Shqipërisë së sotme u ndërrua shumë shpesh. Pranë fuqive të huaja (Napoli, Serbia, Venediku) edhe arisokratët vendas themeluan principatat e tyre. Principata e Karl Topisë në Shqipërinë Qëndrore ekzistoi nga viti 1359 deri 1388. Pothuajse në të njëjtën kohë nga viti 1360 deri 1421 reagan edhe Ballshat me krijimin e principatës së tyre në veri të Shqipërisë dhe Mal të Zi.

1443–1468 princi i Krujës, Skënderbeu udhëhoqi me sukses luftën mbrojtëse kundër turqve. Pas vdekjes së tij shqiptarët dhe aleatët e tyre u mposhtën dhe duke nisur nga fundi i shekullit të 15-të i gjithë vendi, për më shumë se katër shekuj rra nën sundimin e Perandorisë Osmane. Gjatë kësaj kohe pjesa më e madhe e shqiptarëve u kthyen në myslymanë.

Në 1912 pas Luftës së Parë Ballkanike, Shqipëria shpalli pavarësinë me kufijtë e sotëm. Gjermani Wilhelm zu Wied u emërua në vitin 1914 për gjashtë muaj *Princ i Shqipërisë*, por influenza e tij nuk e kaloi kufirin e qytetit të Durrësit. Në jug të vendit grekët formuan shtetin e Epirit të Veriut. Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shqipëria e humbi pavarësinë. Deri në vitin 1919 vendi ishte i pushtuar nga fuqitë që drejtonin luftën.

Që nga viti 1919 deri 1924, Shqipëria u zhyt në trazirat e pasluftës me qeveri që shpërbëheshin shpejt. Në vitin 1920, Kongresi i Lushnjës mundi të vinte themelet e një organizimi të ri shtetëror. Nën drejtimin e Fan Nolit përpjekja për themelimin e një republike demokratike dështoi. 1925 deri 1939 ishte faza e epokës së sundimit autoritar të Ahmet Zogut i cili u vetshpall mbret në vitin 1928. Gjatë kësaj kohe filloi varësia e mëtejshme e Shqipërisë nga Italia dhe në 1939 ndodhi aneksioni italian.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore nga 1939 deri 1944 u zhvillua lufta partizane kundër pushtuesit italian dhe më pas atij gjerman. Këta i kishin lidhur shtetit shqiptar kukull edhe pjesë nga Kosova, Maqedonia dhe Epiri. Në vitin 1944, Shqipëria u çlirua nga sundimi i huaj fashist dhe u vendos dikatatura komuniste nën drejtimin e Enver Hoxhës.

U rivendosën kufijtë e paraluftës. Në katër vitet e ardhshme lidhjet e Shqipërisë dhe Jugosllavisë së Titos morrën formë të ngushtë bashkëpunimi. Në 1948 ndodhi ndarja nga Jugosllavia dhe filloi faza e afrimit me Bashkimin Sovietik.

Në vitin 1949, Shqipëria hyri në Këshillim e Mbështetjes së Ndërsjelltë Ekonomike. Në vitin 1955, vendi u anëtarësua në paktin e Varshavës dhe në të njëjtin edhe në OKB. Viti 1961 ishte viti i shkëputjes nga Bashkimi Sovietik dhe i afrimit me Republikën Popullore të Kinës.

Në vitin 1967 u ndalua totalisht praktika e besimeve fetare. Kjo e bëri Shqipërinë *shtetin e parë ateist*. Një vit më vonë, Shqipëria doli nga Këshilli i Mbështetjes Ekonomike dhe nga Pakti i Varshavës duke ruajtur kursin stalinist. Për disa vjet ekzistuan marrëdhënie shumë të mira me Republikën Popullore të Kinës por që u ndoqën sigurisht nga një vetizolim në vazhdimësi i vendit. Në vitin 1985 vdiq Enver Hoxha dhe pasues i tij u emërua Ramiz Alia. Në vitin 1990 regjimi komunist u përmbys dhe filloi emigrimi në masë i shqiptarëve.

Fillimisht procesi i transformimit u zhvillua me hapa të ngadaltë dhe pa suksese të mëdha. Në vitin 1991 u zhvilluan zgjedhjet e para të lira, fituan komunistët. Vendi hyri në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) dhe në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Demokratët e drejtuar nga Sali Berisha morrën Qeverinë në vitin 1992 dhe filluan reformat. Në vitin 1995 Shqipëria u antarësua në Këshillin Evropian.

Rrënia e sistemit piramidal në vitin 1997 u shoqërua edhe me shkatërimin e strukturave shtetërore. Në vijim u vendos një mision për paqe dhe zhvillim i OSBE-së. Në vitin 1998 referendumi popullor miratoi Kushtetutën e re. Në vitin 1999 vendi pranoi dhjetëmijë refugjatë nga Kosova. Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian Shqipëria e nënshkroi në vitin 2006.

Edhe pse privatizimi dhe ndërtimi i kornizave ligjore kanë shënuar hapa përpara, vazhdojnë të ekzistojnë njëkohësisht probleme strukturore të rënda: Rritja ekonomike mbështetet në rradhë të parë tek ndihma e donatorëve ndërkombëtarë, dërgesat në para të shqiptarëve me banim jashtë vendit si dhe nga ndërtimet dhe investimet me qëllim pastrimin e parasë nga të ardhura ilegale. Rreth një e treta e popullsisë që jeton nga një ekonomi subzistenciale vazhdon të jetë aktive në ekonominë bujqësore e cila përbën dhe një të kërtën e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Edhe turizmi nuk është i zhvilluar. Pothuajse gjysma e popullsisë duhet të jetojë me më pak se dy dollarë në ditë dhe sipas klasifikimit të Bankës Botërore konsiderohet si e varfër.

Një ndër problemet më të mëdha në vend është infrastruktura e dobët. Pjesa më e madhe e rrugëve janë në gjëndje të keqe, furnizimi me ujë të pishëm kufizohet vetëm me disa orë në ditë dhe mungesa e energjisë elektrike gjatë muajve të dimrit është kthyer në rutinë. Kjo situatë largon jo vetëm investorët e huaj por u vështirëson aktivitetin edhe sipërmarrësve të brendshëm për të arritur një prodhimtari me kosto të ulët. Gjëndja u rëndua edhe më shumë pas dhjetorit 2006 me mbylljen e impiantit bërthamor Kosloduj në Bullgari: Shqipëria e cila përfiton energji vetëm nga hidrocentrale, ishte ashtu si dhe vendet fqinje e varur nga importet bullgare.

Rritja ekonomike bazohet në aktivitetin e vazhdueshëm të industrisë së ndërtimit dhe praveç kësaj edhe në aktivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe shërbimet. Bujqësia, industria dhe minierat kanë bërë hapa të ngadaltë për shkak të krizës energjitike e cila pati si pasojë rrënjën e prodhimit. Me 20,7% bujqësia është përbërës domethënës i Prodhimit të Brendshëm Bruto; sektori shërbimeve me 46,4% përbën edhe pjesën kryesore i ndjekur nga ekonomia e ndërtimit me 14,3%. Industria jep kontribut me 9,7% dhe sektori i transporteve me 8,9%.

Përveç kësaj të dhënat zyrtare nuk pasqyrojnë as përafërsisht shkallën e lartë të mungesës së ofertës në tregun shqiptar të punës. Kështu p.sh. antarët e një familjeje fermeri nuk numurohen si të papunë edhe pse një gjysëm duzine me antarë familjarë të rritur në moshë kultivojnë një sipërfaqe jo më të madhe se dy deri tre hektarë.

Banka shtetërore të Shqipërisë u themelua në vitin 1963 dhe u privatizua në vitin 1992. Banka përpiqet të mbajë të qëndrueshëm ose madje të ulë kursin me dollarin amerikan US, euron, paundin dhe frangën zviceriane. Detyrë tjetër e rëndësishme e këtij institucioni është edhe ruajtja e qëndrueshmërisë së çmimeve të cilët kohët e fundit kanë pësuar rritje.

Megjithë vullnetin politik, turizmi nuk mundi të kthehet në një faktor të fortë ekonomik. Në vitin 2004 të ardhurat nga ky sektor ishin 735 milionë. Një nga sektorët ekonomikë më domethënës sidomos në qendrat si Tirana, Durrësi, Vlora, Korça dhe Saranda është ai i ndërtimit. Në mungesë të alternativave paraja investohet pothuajse vetëm në pasuri të paluajtshme.

Partnerë të rëndësishëm për tregtinë me jashtë, si për importet ashtu dhe për eksportet –sipas rradhës– janë Italia, Greqia dhe Gjermania. Sipas statistikave vijojne vendet ballkanike. Përkrah kësaj ka një numër të vogël eksportesh për Suedi, Francë, Turqi (Stamboll) për Japoni dhe Shtetet e Bashkuara. Eksportohen produkte ushqimore të përpunuara, krom, tekstile, vaj i parafinuar, asfalt dhe pambuk. Importi përbëhet nga produkte ushqimore, makineri, lëndë kimike, tekstile dhe artikuj të tjerë konsumi.

Bujqësia

Si vend tradicionalisht agrar, bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm në Shqipëri. Rreth një e katërta e sipërfaqes – 7.000 km² – mund të përdoret për qëllime bujqësore. Klima është e favorshme për çdo lloj bujqësie dhe blegtorie. Cilësia e tokës varion sipas krahinës dhe pozicionit.

22% e PBB përfitohet nga aktivitetet bujqësore. Në vitin 2004 ishte pothuajse 60% e popullsisë aktive e punësuar në sektorin e bujqësisë. Sigurisht që pjesa më e madhe ushtron bujqësi subzistenciale. Prodhimi bujqësor vazhdon të jetë i pakët. Problem kryesor është mungesa e investimeve në makineri dhe impiante si dhe në ritrajtim të pjellorisë së tokës, sistemet ujitëse janë të pamjaftueshme, mungon personel i arsimuar me metoda moderne dhe lidhjet me tregun. Copëzimi i sipërfaqjes së mbjellë dhe presioni psikologjik nga sindikatat paraqesin probleme të tjera strukturore të cilët do të ngadalësojnë edhe në vitet në vijim zhvillimin e sektorit bujqësor shqiptar.

Zbatimi i standarteve cilësore, përmirësimi i arsimit profesional, diversifikimi i prodhimit dhe hapja e rrugëve të reja shpërndarëse mund të përmirësonin në term afatshkurter dhe afatmesëm cilësinë dhe sasinë e prodhimit bujqësor, të kontribuonin në uljen e deficitit të bilancit tregtar dhe në plotësimin e nevojave të tregut kombëtar me prodhime

ushqimore bazë (fruta, perime, qumësht, drithëra) si dhe me prodhime të gatshme ose gjysëm të gatshme (peshk, prodhime të qumshit, koncentrat frutash dhe perimesh, mjaltë, erëza dhe bimemjeksore).

Taktikë:

Ju jeni përfaqesuese/përfaqësues i vendit tuaj. Mos harroni: qëllimi juaj është antarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian! Atëherë duhet të bindni partnerët e bisedimeve mbi pjekurinë e Shqipërisë. Referojuni sukseseve të punës së Qeverisë suaj dhe informoni në lidhje me reforma të tjera të planifikuara.

Shqipëria ka shënuar hapa të ndjeshëm në sektorin e demokratizimit dhe shtetit ligjor. Kjo vlen edhe për atë të respektit ndaj të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve si dhe përforcimit të së drejtës së pronës. Shqipëria vazhdon të luaj një rol pozitiv për sigurimin e stabilitetit në rajon dhe ka kontribuar në përmbylljen e Marrëveshjes për Tregtinë e Lirë me rajonin (CEFTA). Njëkohësisht duhen përmirësuar raportet demokratike dhe duhet ndërtuar një sistem partiak funksional si bazë e demokracisë.

Shqipëria ka bërë hapa pozitivë në krijimin e një ekonomie tregu funksionale. Tashmë kërkohen përpjekje të mëtejshme për reforma të rëndësishme të cilat do të ndihmojnë në terma afatgjate përballjen me trysinë e konkurrencës dhe fuqisë së tregut brenda Bashkimit Evropian. Shifra zyrtare për shkallën e papunësisë është ende e lartë por po shkon në rrënie. Privatizimi shënoi hov të ri në vitin 2007. Situata kritike e furnizimit me energji sigurisht që përbën një pengesë për suksese të vërteta në këtë fushë.

Shqipëria ka shënuar suksese në përafrimin e legjislacionit, masave në politikë, kapaciteteve sipas standardeve evropiane dhe në zbatimin e detyrimeve tregtare që rrjedhin nga Marrëveshja e Interimit. Në disa sektorë si ai doganor, tatimor dhe atë të konkurrencës dhe luftës kundër korrupsionit i referohemi sukseseve të viteve më parë edhe pse këto nuk i plotësojnë pritshmëritë e Bashkimit Evropian.

Për sa i përket çështjes së pavarsisë së Kosovës, ju e keni mbështetur gjithmonë dhe në çdo kohë dhe dëshëroni edhe për Kosovën një anëtarësim po kaq të shpejtë në Bashkimin Evropian. Bisedoni dhe përpiquni të fitoni përkrahjen e Spanjës, Greqisë, Qipros, Rumanisë dhe Sllovakisë për njohjen e statusit të pavarsisë së Kosovës si hap i parë drejt BE-së.

Në lidhje me „çështjen e emërimit“, mund të luani rolin e ndërmjetësuesit dhe të fitoni pikë. Nga njëra anë kërkoni të mbështetni shqiptarët që jetojnë në Maqedoni nga ana tjetër jeni të interesuar të mbani marrëdhënie të mira me Greqinë.

Përkundrazi, në sektorë të tjerë si ai i transportit dhe ai i së drejtës për pronën shpirtërore sukseset kanë qënë të kufizuara.

Përpiquni të fitoni përkrahjen veçanërisht të Italisë në lidhje me dëshirën për anëtarësim dhe kujtoni një detyrim historik të vendit.

Bosnje dhe Hercegovina

Kryeqyteti:	Sarajevë
Forma shtetërore:	Republikë
Sipërfaqja:	51.129 km ²
Banorë:	3,926 Mil.
PBB/banor:	32.30 US-Dollar
Rritja ekonomike:	6,0% (2005)
Papunësia:	31,0% (2006)
Gjuhët:	boshnjake, kroatisht, serbisht
Besimet fetare:	muslimanë, të krishterë ortodoksë, katolikë
Grupe etnike:	48% Boshnjakë, 37% serbë, 14% kroatë
Kryetar shteti:	Presidium shtetëror, përbërë nga një përfaqësues i boshnjakëve kroatë, një i boshnjakëve dhe një i serbëve boshnjakë; Kryesia ka rotacion një herë në 8 muaj
Kryetar qeverie:	Nikola Spiric (Kryetar i Këshillit të Ministrave)
Informacione të tjera:	www.botschaftbh.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni delegat/e i/e Bosnje-Hercegovinës në bisedimet me BE. Ju synoni anëtarësimin sa më të shpejtë të mundur të vendit Tuaj në BE. Gjatë bisedimeve mund të shfrytëzoni informacionet e mëposhtme rreth historisë, politikës dhe ekonomisë së vendit Tuaj. Natyrisht që informacionet më pak të favorshme Ju mund edhe t'i fshihni apo t'i servirni më bukur. Mbani gjithmonë parasysh, objektivi Juaj është anëtarësimi i shpejtë në BE i vendit Tuaj!

Procesi i shpërbërjes së Ish-Jugosllavisë ka shkaktuar 20 vitet e fundit shumë vuajtje dhe gjakderdhje. Me ditën e shpalljes së pavarësisë së Bosnje-Hercegovinës komuniteti ndërkombëtar shpreson më në fund të hidhen pas fantazmat e të shkuarës, dhe të shihet përpara, drejt të ardhmes së paqte. Për të gjithë Ballkanin Bashkimi Evropian uron një të ardhme në paqe, stabilitet dhe prosperitet ekonomik. Të njëjtin qëllim ndiqni edhe Ju.

Objektivi më i rëndësishëm i politikës së Bosnje-Hercegovinës është përafrimi apo përfshirja në strukturat euroatlantike me qëllim anëtarësimin në BE dhe NATO. Ky është edhe konsensusi i të gjitha partive politike në një shtet që bazohet mbi parimin e barazisë etnike mes tre grupimeve më të rëndësishme popullore. Pranimi i vendit në programin e NATO-s „Partneriteti për paqe“ në Samitin e NATO-s, në Riga Dhjetor 2006, ishte një inkurajim në këtë rrugë. Samiti i NATO-s në Bukuresht, prill 2008, vendosi hapjen e një dialogu të intensifikuar si një hap të mëtejshëm në drejtim të Integritimit euroatlantik.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)

Bisedimet rreth Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE mundën të mbylleshin në dhjetor 2006. MSA u siglua më 4.12.2007 dhe u nënshkrua më 16.6.2008. BE vuri si kusht për nënshkrimin e MSA një reformë të kërkuar prej kohësh në sistemin policor.

Deri në atë moment forcat policore të të dy pjesëve të vendit të Republika Srpska dhe Federatës boshnjako-kroate nuk bashkëpunonin me njëra-tjetrën. Kjo nga ana tjetër bëhej pengesë për kërkime të përbashkëta të kriminelëve eventuale të luftës. Pas një periudhe pothuaj katër-vjeçare bisedimesh Parlamenti Boshnjak vendosi në prill 2008 për realizimin e reformave në polici. Kjo reformë në fakt nuk i bashkoi forcat policore të të dy pjesëve të vendit në një polici të vetme, por të dyja palët tanimë garantonin se do të bashkëpunonin më ngushtë me njëra-tjetrën.

Marrëveshja, e cila përmban edhe një sërë lehtësirash në fushën e tregtisë, ka hyrë në fuqi më 01.07.2008 dhe konsiderohet si një hap i rëndësishëm drejt BE.

Teorikisht Marrëveshja ofron avantazhe si për vendet candidate për anëtar të BE ashtu edhe për shtetet anëtare. Këto kanë të bëjnë veçanërisht me tregtinë, pasi parashikohet heqja graduale e doganave dhe përmes kontratave në fushën e tregtisë dhe transporteve shteti përmirëson Credit-rating e vet. Në tërësi kjo do të çonte në rritjen e investimeve të huaja. Krahas kësaj vendet candidate për anëtarësim do të kenë më shumë akses në fondet e BE, prej të cilave mund të aplikohet l për mbështetje në masë jo të vogël në zhvillimin e bujqësisë, arsimit, shëndetit shkencës apo edhe kulturës dhe artit.

Përshtatja e kuadrit ligjor të Bosnje-Hercegovinës me normat e BE – janë rreth 1200 ligje – është një ndër pjesët më të rëndësishme të Marrëveshjes. Ky adaptim duhet të realizohet në gjashtë vitet e ardhshme. Shumë politikanë në Bosnje-Hercegovinë do të përpiqen të mbrojnë interesat e tyre lokale, t'i bëjnë bisht marrëveshjes ose edhe deri ta bllokojnë atë.

Nënshkrimin e Marrëveshjes politikanët e Bosnje-Hercegovinës e kanë perceptuar si një sukses personal. Por këtu kanë harruar që MSA është më shumë një dhuratë bërë Bosnje-Hercegovinës – sikurse ishte edhe rasti i Serbisë. Por ndërsa përkundrejt Serbisë Marrëveshja ishte menduar si kompensim për humbjen e Kosovës, në rastin e Bosnje-Hercegovinës BE kishte më tepër arsye morale: do të kishte qenë jokorrekte, që Bosnje-Hercegovina të lihej pas Serbisë në lidhje me Integrimin në BE.

Angazhimi në BE

Megjithë thëngjijtë ende të ndezur të konflikteve etnike Bashkimi Evropian përpiqet të angazhohet shumë në këtë shtet të Ballkanit: që prej fillimit të viteve '90 deri në vitin 2000 Komuniteti ka vënë në dispozicion të tij më shumë se 2 mrd. euro. Programet e financuara atëherë nga BE i shërbenin asistencës së pasluftës, dhe mbështesnin në rradhë të parë refugjatët e luftës civile dhe rindërtimin.

Njerëzit në Bosnje-Hercegovinë

Tre etnitë zyrtare të këtij vendi flasin gjuhë shumë të afërta me njëra-tjetrën atë boshnjake, serbe dhe kroate. Në varësi të këndvështrimit këto gjuhë cilësohen edhe si serbo-kroatish.

Shtetasit e Republikës së Bosnjes dhe Hercegovinës cilësohen shpesh bosnjas, dhe këtu përfshihen edhe serbët dhe kroatët, që jetojnë në Bosnje dhe Hercegovinë. Ndërsa termi boshnjakë përdoret vetëm për muslimanët.

Feja në Bosnje dhe Hercegovinë

Në Bosnje dhe Hercegovinë bashkëjetojnë prej shekujsh fe dhe besime të ndryshme. Pjesa më e madhe e banorëve i nënrenditet në mënyrë formale njërit prej dy komuniteteve të mëdha fetare monoteiste (krishtërimin dhe islamit). Në Mostar gjatë periudhës së luftës është krijuar një bashkësi e vogël evangjeliste me serbë, kroatë dhe boshnjakë.

E shkuara në Bosnje dhe Hercegovinë

Bosnja dhe Hercegovina përbëhet nga dy rajone historike, që nuk kanë lidhje me ndarjen e sotme në entitete, Bosnja dhe Hercegovina. Emri Bosnje rrjedh nga emri i lumit Bosnja, i cili e ka burimin afër kryeqytetit Sarajevë. Ndërsa emri Hercegovinë e ka prejardhjen nga titulli prej sundimtari „Herzeg“ (Herzog – Dukë; Herzegovina-Herzogsland-dukatë). Kongresi i Berlinit i vitit 1878 i vendosi provincat osmane të Bosnjes dhe Hercegovinës si dhe Sanxhakun e Pazarit të Ri nën administrimin austro-hungarez. Aneksimi formal përmes monarkisë së dyfishtë çoi në krizën boshnjake të aneksimit të vitit 1908. Pas Luftës së Parë Botërore vendi u bë pjesë përbërëse e Mbretërisë së serbëve, kroatëve dhe sllovenëve.

Administrata e Bosnje dhe Hercegovines

Bosnja dhe Hercegovina shpalli më 15 tetor 1991 shkeputjen e saj nga Federata Jugosllave dhe që prej asaj kohe është një republikë e pavarur. Njohja ndërkombëtare e kësaj republike u bë më 17 prill 1992. Pas kësaj vijuan tre vite lufte mes njësive serbe, kroate dhe muslimano-boshnjake. Në përfundim të luftës së Bosnjes në vitin 1995 u lidh Marrëveshja e Dayton-it sigluar në Dayton (SHBA) dhe e nënshkruar në Paris (14 dhejtor), mbi bazën e së cilës u krijua Republika Federale e Bosnje-Hercegovinës, e cila vazhdon ende të vuajë pasojat e luftës dhe konflikteve të vazhdueshme mes grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

Ndarja politike e shtetit është komplekse. Që prej Marrëveshjes së Dayton-it (njohur ndryshe si Marrëveshja e Paqes së Dayton-it) Bosnje dhe Hercegovina përbëhet nga dy entitete: Federata e Bosnje dhe Hercegovinës (Federacija Bosne i Hercegovine, njohur ndryshe si Federata boshnjako-kroate) dhe Republika Srpska (Republika Serbe). Të dy këto entitete kanë nga një Ekzektutiv dhe Legjislativ të vetin. Federata e Bosnje dhe Hercegovinës përbëhet nga dhjetë kantone, të cilat në shumë aspekte kanë kompetencat e tyre të mëvetësishme.

Kompetenca të nivelit shtetëror ishin fillimisht politika e jashtme, ajo financiare dhe marrëdhëniet e ekonomisë me jashtë. Në vitet e shkuara kompetencat e shtetit qendror u plotësuan me detyra të tjera (mbrojtja, dogana dhe tatimet indirekte, ndjekja dhe gjykimi i kriminelëve të luftës dhe lufta kundër krimeve të rënda).

Politika në Bosnje dhe Hercegovinë

Zgjedhet e darës 1 tetor 2006 u vlerësuan si të orientuara për nga e ardhmja, pasi Komuniteti Ndërkombëtar në vitin 2007 donte të largonte Përfaqësuesin e Lartë nga Bosnje dhe Hercegovina dhe ta linte vendin në pavarësinë e plotë të tij. Më pas ky projekt u shty edhe për një vit.

Bosnje-Hercegovina i ka zgjeruar marrëdhëniet kontraktuale me Bashkimin Evropian në mënyrë të vazhdueshme këto vitet e fundit dhe një anëtarësim i plotë i Bosnje-Hercegovinës në BE do të ishte i mundshëm në të ardhmen. Por deri atëherë ky shtet i Ballkanit duhet të përmirësojë gjendjen e vet ekonomike, të zgjerojë strukturat demokratike dhe të eliminojë tensionet teknike.

Gjendja ekonomike e Bosnje-Hercegovinës

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) nga viti 2006 në 2007 u rrit me 0,6%. Me shtimin e prodhimit industrial rritja ekonomike duhet të mbetet te psë deri gjashtë për qind edhe në vitet e ardhshme. Kërkesat nga i gjithë rruzulli për lëndë të parë (veçanërisht në fushën e metaleve), janë diçka pozitive për këtë vend, që ka pasuri jo të pakonsiderueshme në lëndë të parë. Reforma në fushën e legjislacionit ekonomik ka bërë hapa përpara, ato që shkaktojnë shpesh probleme janë dispozitat ligjore që mendojnë apo që janë kontradiktore. Konceptimi i administratës si në shërbim të ekonomisë dhe popullsisë është jo shumë i prerë, po kështu krijimi i një zone të njësuar ekonomike bën përpara me ritme të ngadalta. Krijimi dhe zgjerimi i një sistemi elektronik për trojet dhe kadastrën nxitet të realizohet edhe në interes të investitorëve.

Bosnje dhe Hercegovina ofron potenciale të rritjes ekonomike në sektorët ekonomikë të industrisë së energjisë elektrike (eksportuesi i vetëm i energjisë elektrike në rajon), në bujqësi (produkte bio), industrinë e përpunimit të drurit, industrinë e ndërtimit (veçanërisht infrastrukturën e qarkullimit), përpunimin e metaleve dhe turizëm.

Taktika:

Ju jeni përfaqësues/e i/e vendit Tuaj. Mbani parasysh: Qëllimi Juaj është anëtarësimi në Bashkimin Evropian. Pra Ju duhet të bindni partnerët Tuaj në bisedime në lidhje me pjekurinë e Bosnje dhe Hercegovinës për anëtarësim. Sillni në vëmendje sukseset e mëdha të punës së qeverisë dhe sqaroni planet për reformat e mëtejshme.

Gjithsesi bëni të qartë se nuk druheni nga përpjekjet për të arritur ndryshime në vendin Tuaj.

Lidhur me përmbushjen e kriterëve politike ritmi i vendit është ngadalësuar. Në fushën e administratës publike janë bërë disa hapa përpara, por kërkohen përpjekje të mëtejshme. Bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë (ICTY) është përmirësuar dhe në tërësi është e kënaqshme. Vendi merr pjesë aktive në bashkëpunimin rajonal dhe është palë në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë për Rajonin (CEFTA). Gjithsesi udhëheqja politike e vendit nuk pati sukses në reformimin e policisë. Gjendja e palëvizshmërisë në këtë sektorë por edhe në sektorë të tjerë vonon në një masë të konsiderueshme lidhjen e MSA dhe frenon reformat. Gjithashtu vendi duhet të bashkëpunojë në mënyrë të pakufizuar me ICTY.

Kriteret ekonomike

Bosnje-Hercegovina nuk ka bërë shumë përpara në krijimin e një ekonomie tregu funksionale. Duke qenë se papunësia vazhdon të jetë në shifra të larta, ky është një shkak për t'u shqetësuar shumë. Janë të nevojshme reforma të gjera, me qëllim që vendi të mund t'i bëjë ballë trysnisë së konkurrencës dhe forcave të tregut brenda Unionit.

Sillni në vëmendje që rritja ekonomike vazhdon të mbetet e lartë dhe se inflacioni ka rënë në vijueshmëri. Federata e Bosnje-Hercegovinës ka thjeshtuar sistemin e taksave dhe ka ulur barrën fiskale. Investimet e huaja direkte shënuan rritje të dukshme në vitin 2007 dhe kontribuuan në financimin e deficitit të tregtisë së jashtme. Aftësia konkurruese e çmimeve u ruajt në pjesën më të madhe të tyre.

U realizua përqendrimi i të gjitha kompetencave ligjvënëse dhe buxhetore për çështje të policisë në nivel gjithëshetëror, mos-përzierja politike në punën praktike të policisë dhe përcaktimi i distrikteve të policisë mbi bazën e kritereve teknike.

E megjithatë reformat si në nivel entitetesh ashtu edhe në atë qeveritar u frenuan nga mungesa e rënies dakord në lidhje me parimet e politikave ekonomike. Strukturat e ngurta në tregun e punës pengojnë krijimin e vendeve të punës. Vendi vazhdon të ketë një sektor të gjerë publik.

Standardet evropiane

Bosnje dhe Hercegovina ka shënuar një progres të kufizuar në përshtatjen e kuadrit ligjor dhe politikës së saj me standardet evropiane. Në sektorë të tillë si konkurrenca, transporti, energjia, arsimiti, politika e vizave dhe e azilit janë shënuar edhe hapa përpara. E megjithatë në sektorë të tjerë si lëvizja e lirë, politika sociale dhe punësimi ka patur shumë pak arritje. Këtë Ju nuk mund ta mohoni.

Propagandoni me forcë interesat Tuaja dhe bëni të qartë, që Ju keni bërë hapat e parë të suksesshëm në drejtim të Bashkimit Evropian dhe se për Ju është e rëndësishme mbështetja e mëtejshme e Bashkimit Evropian. Dhënia e statusit të një vendi kandidat mund të jetë një shenjë e rëndësishme për të nxitur përpjekje të tjera të vendit Tuaj si dhe për të bërë të mundur, që të ruhet një ritëm i lartë i përafrimit me BE.

Kroacia (Hrvatska)

Kryeqyteti:	Zagrebi (1 Mln. banor)
Forma shtetërore:	Republikë
Sipërfaqja:	56.542 km ²
Banorë:	4,441 Mln.
PBB/banor:	9.310 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	4,8%
Papunësia:	11,6%
Gjuhët:	kroatisht, serbisht, hungarisht, italisht
Besimi fetar:	katolikë 90%, serb-ortodoksë 4%, muslimanë 1%, u.a.
Grupet etnike:	89,6% kroatë, 4,5% serbë, 0,5% boshnjakë, 0,4% hungarezë, 0,3% sllovenë, 0,2% çekë, 0,2% romë, 0,1% shqiptarë, 0,1% malazezë, 4,1% të tjerë (2001).
Kryetar shteti:	Stipe Mesic
Kryetar qeverie:	Ivo Sanader
Informacione të mëtejshme:	www.kroatische-botschaft.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni e/ ideleguar i Kroacisë në bisedimet me Bashkimin Evropian. Ju synoni anëtarësimin sa më të shpejtë të vendit Tuaj në Bashkimin Evropian. Gjatë bisedimeve, Ju mund t' i referoheni të dhënave nga historia, politika dhe ekonomia e vendit Tuaj. Natyrisht Ju lejohet të fshihni ose të përmirësoni disa të dhëna pak të këndshme. Mos harroni se qëllimi Juaj është anëtarësimi i shpejtë i vendit Tuaj në Bashkimin Evropian!

Historia e Kroacisë dhe luftrat civile në ish-Jugosllavi

Deri në vitin 1918 Kroacia ishte pjesë e Perandorisë Austro-Hungareze. Pas Luftës së Parë Botërore Kroacia u bashkua me Serbinë dhe Slloveninë duke formuar kështu një shtet federal i cili në vitin 1929 u deklarua „Mbretëria Jugosllave“. Pas Luftës së Dytë Botërore Jugosllavia ajo ndodhej nën sundimin socialist të Josep Titos i cili njësoi Bashkësinë Shtetërore Sllave të Jugut nën një drejtim të rreptë. Pas vdekjes së Titos, në vitin 1980 dhe veçanërisht pas rrënies së perdes së hekurt, kudo në Jugosllavi u vunë re përpjekje të grupeve të ndryshme të popullsisë për pavarësi. Pas një faze të gjatë recesioni ekonomik, në fillim të viteve nëntëdhjetë, në rajonet multietnike të ish-Jugosllavisë filluan një sërë mosmarrëveshjesh të dhunëshme.

Lufta në Kroaci filloi në vitin 1991, pas referendumit me anë të së cilit kroatët me shumicë votash kishin vendosur për pavarësi dhe pas përplasjeve midis serbëve dhe kroatëve në krahinat Krajina dhe Slavonia. Në vitin 1991, Kroacia ashtu si më parë Sllovenia, u deklarua e pavarur edhe pse vendi në pjesën më të madhe të tij ishte ende i pushtuar nga ushtria jugosllave e cila zotrohej nga serbët. Njësitë kroate luftuan edhe në Bosnjë-Hercegovinë kundër ushtrisë jugosllave. Përveç kësaj, më 1993 aty pati luftime mes kroatëve bosnjakë dhe myslymanëve. Me anë të një ofensive Kroacia mundi të merrte kontrollin në krahinat e pushtuara nga serbët vetëm në fillim të muajit gusht 1995 deri në

dhjetor 1995 kur më në fund aprovoi marrëveshjen Dayton-it e cila i dha fundin luftës civile në Ballkan.

Sistemi politik dhe politika e brendshme

Sistemi politik i Kroacisë është presidencial, d.m.th. Presidenti kroat influencon ndjeshëm sektorë politikë të rëndësishëm (veçanërisht politikën e jashtme) të vendit. Përqëndrimi i pushtetit tek presidenti i atribuoi Franjo Tudjman i cili e drejtoi vendin gjatë viteve të luftës duke i dhënë atij pavarësinë. Në vitin 2001 një reformë kushtetuese i delegoi Qeverisë disa nga kompetencat e Presidentit dhe një pjesë të vogël të tyre Parlamentit.

Në politikën e brendshme të vendit ndihen ndjeshëm dhimbjet e pasluftës. Për këtë arsye, qëllimi i Qeverisë është shërimi i menjëhershëm i ekonomisë së vendit i cili aspirohet sëbashku me anëtarësimin në NATO dhe BE. Në këtë kontekst, që prej vitit 2000 Kroacia ka bërë hapa themelorë edhe pse sistemi i drejtësor është ende i prapambetur. Sidoqoftë në Kroaci është krijuar një kulturë politike me tendenca demokratike e cila mbështetet nga ambientet e larmishme partiake, ato të shtypit si dhe nga rritja ekonomike. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit nënshkruar në vitin 2001 me BE-në, Kroacia është e detyruar brenda gjashtë vjetësh të përafroje 60 përqind të sistemit drejtësor të BE-së me sistemin drejtësor kombëtar.

Natyrisht në sektorë kyç ka ende sfida të medha të cilat duhen kapërcyer, si:

- reforma në sistemin ligjor inefiçent
- reforma në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit ende të përhapur në shumë fusha.
- Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar të drejtës së minoriteteve, në radhë të parë kthimit të refugjatëve.
- Me kujdes duhet trajtuar edhe çështja e ndjekjes së kriminelëve të luftës.
- Vazhdimësia e bashkëpunimit rajonal ashtu si edhe përpjekjet për zgjidhjen e problemeve dypalëshe me vendet fqinj, veçanërisht në lidhje me vendosjen e kufijve, merr një rëndësi domethënëse.

Situata e refugjatëve dhe politika e Kroacisë për minoritetet

Problem të madh përbën situata e 320 000 refugjatëve që jetojnë në Kroaci nga të cilët, sipas të dhënave të zyrës së Kombeve të Bashkuara, 108 000 janë me përkatësi serbe. Dyndjet masive të refugjatëve janë gjithashtu pasojë e lufës midis grupeve etnike të ndryshme dhe dëbimeve që kanë rezultuar nga kjo. Pjesa më e madhe e refugjatëve janë refugjatë të brendshëm kroatë ose refugjatë që vijnë nga Bosnja-Hercegovina e cila ndodhet në kufi dhe ku kroatët përbejnë një pjesë të madhe të popullsisë. Në kuadër të Paktit të Stabilitetit me Evropën Juglindore, Kroacia bashkëpunon me vendet ish-kundërshtarë në luftë për sa i përket çështjes së refugjatëve. Pjesa më e madhe e të dëbuarve synon integrimin në shoqërinë kroate pasi edhe krahinat nga këta vijnë janë ekonomikisht të shkatëruara dhe ende të minuara (3 përqind e sipërfaqes së Kroacisë). Përveç kësaj, shumë prej tyre në rastin e kthimit kanë frikë nga diskriminimi.

Në Kroaci jetojnë minoritete të shumta (serbë, sllovenë, italianë, hungarezë, boshnjakë, sllovakë, gjermanë, shqiptarë, romë) nga të cilët, serbet me 4,5 përqind (përpara luftës 12 përqind) përbëjnë pjesën më të madhe të minoritetit. Që prej vitit 2002 minoritetet në Kroaci gëzojnë më shumë të drejta çka pasqyrohet në përfaqësimin e tyre në Parlament ku nga 125 vende atyre u janë rezervuar pesë deri tetë vende. Gjithashtu ata

mund të oragnizohen në parti politike dhe gjuha dhe shkrimi i tyre ka të drejta të barabarta në krahinat ku ato përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë.

Ekonomia e Kroacisë

Edhe tek ekonomia e Kroacisë ndihen pasojat e luftës. Nga viti 1990- 1992 pagat rranë në një të tretën në krahasim me vitet e mëparshme. Deri në vitin 1995 prodhimi industrial u reduktua në afro 50 përqind në krahasim me vitin 1989 çka solli një rritje të madhe të papunësisë me rreth 30 përqind. Sipas të dhënave zyrtare të Qeverisë kroate dëmet direkte dhe indirekte të luftës shkojnë pothuajse në 30 miliardë euro, d.m.th më shumë se trefishi i Prodhimit të Brendshëm Bruto të Kroacisë.

Në vitet e fundit Kroacia ka shënuar suksese të konsiderueshme në ekonomi. Në vitin 2003 ekonomia u rrit me 4,5 përqind, shkalla e inflacionit u ul në 1,5 përqind duke paraqitur edhe vlerat më të mira nga gjithë vendet në transformim të Evropës Lindore. Të dhënat ekonomike janë më të mira se ato të shumë vendeve të tjera tashmë të anëtarësuar. Megjithatë zhvillimi ekonomik vuan ende nga shkalla e lartë e papunësisë, mungesa e sistemit social dhe borxhi i lartë i shtetit çka e detyron Qeverinë të zbatojë një politikë kursimi. Në sektorin e bujqësisë dhe ndërtimit të anijeve privatizimi i ndërmarjeve ish-shtetërore ka ecur me hapa shumë të ngadalta. Përveç kësaj Kroacia duhet të luftojë edhe shkallën e lartë të korrupsionit. Mungesa e sigurisë ligjore, kostot e larta të prodhimit dhe monedha vendase e mbivlerësuar „Kuna“ e cila e ndrydh eksportin e prodhimeve kroate vlejën si fusha problematike të ekonomisë kroate.

Në të kundërt një nga shtyllat mbështetëse të vendit është ajo e turizmit në lulëzim (veçanërisht në bregdet) i cili përbën 21 përqind të PBB si dhe industria e përpunimit (rreth 17 përqind). Ne lidhje me këtë Kroacia tradicionalisht ka mundur të shfrytëzojë fuqinë puntore profesionale të arsimuar.

Marrëdhëniet ekonomike me BE-në përbëjnë 57 përqind të volumit tregtar me jashtë. Italia, Gjermania, Austria dhe Sllovenia janë partnerët më të mëdhjenj tregtar të cilët kryejnë pjesën më të madhe të investimeve të huaja në Kroaci. Reformat ekonomike të deritanishme në vend janë vlerësuar pozitivisht nga Komisioni i BE-së. Që prej marsit të vitit 2003 Kroacia është antare e Zonës për Tregtinë e Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), asaj i akordohet ndërmjet „Programit CARD“ (Asistenca Komunitare për Rindërtim dhe Zvillim) mbështetje zhvillimi speciale nga BE-ja si dhe është partnere aktive në Paktin e Sabilitetit për Evropën Juglindore.

Politika e jashtme e Kroacisë

Qëllim prioritar i politikës së jashtme të Kroacisë është integrimi sa më shpejt i mundur në BE dhe NATO. Kjo i premtun Kroacisë avantazhe ekonomike edhe në politikat e sigurisë. Për sa i përket politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, që prej vitit 2000 Kroacia merr pjesë në programin „Partnership-for-Peace“ dhe është anëtare e grupit Vilnius „Vilnius Gruppe“ të aspirantëve për anëtarësim në NATO. Në fillim të vitit 2003 Kroacia i paraqiti Komisionit të BE-së kërkesën për anëtarësim dhe që prej korrikut 2004 është kandidant zyrtar për anëtarësim.

Marrëdhëniet me BE-në rëndohen nga ritmet e ngadalta të ekstradimit të kriminelëve të dyshuar të luftës Gjykatës së Hagës për çështjet e ish-Jugosllavisë. BE-ja e ka deklaruar

bashkëpunimin me Gjykatën Penale si kusht thelbësor për anëtarësim në BE. Pranimi i planifikuar për vitin 2005 në bisedimet për anëtarësim u shty për këtë arsye.

Pas dorëzimit të ish Gjeneralit Ante Gotovina Gjykatës Penale për çështjet e ish-Jugosllavisë (ICTY) në Hagë, në fund të vitit 2005, rasti i kriminelit të mundshëm të luftës, Branimir Glavas bëri shumë bujë. Politikani i njohur u akuzua ndër të tjera për rrëmbimin, torturimin dhe vrasjen e civilistëve serb ndërsa drejtonte luftimet për mbrojtjen e qytetit Osijek në lindje të Kroacisë kundër ushtrisë jugosllave dhe milicëve-serbë në fillim të luftës në vitin 1991. Glavas është deri tani politikani më i lartë kroat i cili akuzohet për krime lufte.

Me anë të një greve urie prej disa javësh kundër këtij procesi të cilin ai e konsideroi si një komplot të konkurrentëve të tij politik, dhe i mbështetur nga mediat nacionaliste dhe përfaqësuesve të opinionit publik, Glavas ia doli mbanë më 02.12.2006 të lirohej nga burgimi për arsye shëndetësore dhe të pezullonte çështjen deri në afat të papërcaktuar. Në datë 18.4.2007 u arrestua përsëri. Përpara kësaj, Qeverisë i ishte dashur të diskutonte me BE-në për hapat e ndërmarrë në zhvillimin e shtetit ligjor. Sëbashku me Glavas edhe gjashtë kroatë të tjerë do të përgjigjen për krime lufte në Osijek.

Në lidhje me procesin e ish Gjeneralit Gotovina nga ICTY në datë 21.2.2007, Gjykata hoqi nga katalogu i akuzave disa pika me qëllim përshpejtimin e procesit. Gotovina duhet të përgjigjet për krime të rënda lufte që janë kryer nga trupat kroate në vitin 1995 gjatë ripushtimit të krahinës Krajina të pretenduar nga serbët. Përfaqësuesit e akuzës u shprehën kundër shkurtimit të pikave akuzuese.

Më 12.6.2007 Gjykata e Hagës dënoi ish drejtuesin e serbve kroatë, Milan Martić me 35 vjet burgim. Ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe Njëanshme Serbe e Krajinës në Kroaci (e ripushtuar nga trupat kroate në vitin 1995) u dënua si fajtor për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në veçanti në kontekst me të ashtuquajturin spastrim etnik.

Duke marrë shkak nga një fjalim i Presidentit të Italisë më 10.02.2007 me rastin e 60-vjetorit të shkëputjes së krahinave italiane në Istria, Dalmaci dhe Venecia-Juliane (sipas Marrëveshjes së Parisit për Paqen e vitit 1947), Presidenti kroat Stipe Mesic akuzoi homologun e tij, Giorgio Napolitano për „racizëm të hapur, revizionizëm historik dhe revanshizëm politik“. Përkrah trishtimit në lidhje me viktimat italiane gjatë masakrës në Istria nga trupat jugosllave partizane të drejtuara nga Tito pas Luftës së 2. Botërore, Napolitano u shpreh se përmes këtyre akteve mizore janë vënë në zbatim „planet sllave për aneksim“ dhe si pjesë e saj „spastrimi etnik“ i gadishullit. Në datë 18.02., pas një proteste të fortë nga ana e Ministrisë të Punëve të Jashtme të Italisë, Massimo D'Alema, Mesic i tërhoqi të gjitha akuzat e tij në formë dhe përmbajtje. Edhe Komisioni i BE-së i tërhoqi vëmendjen drejtuesit kroat në lidhje me përzgjedhjen e fjalorit të tij. Për kundërpeshë Qeveria italiane siguroi se nuk synonte në asnjë mënyrë rishikimin e Marrëveshjes për Paqe lidhur me ish- Jugosllavinë dhe do të mbështeste pa rezerva kandidaturën e Kroacisë për antarësim në BE.

Një konflikt i mëtejshëm është ai me vendin fqinj, Slloveninë në lidhje me vijën e saktë kufitare detare të të dy vendeve. Ky konflikt është rënduar diçka në vitet e fundit dhe është marrë në trajtim nga Gjykata Penale Ndërkombëtare.

Duke aluduar në lidhje me shpalljen e zonës së anëshme ekologjike të peshkimit dhe diskutimit mbi çështjen e kufirit, Komisioni ka thksuar se Kroacia nuk e ka harruar kriterin tjetër për anëtarësi, d.m.th lidhjet e mira me shtetet fqinjë.

Në fillim të vitit 2008 u vu re që bisedimet me Kroacinë po bllokoheshin: Zona e njëanshme e peshkimit shpallur në datë 1 janar 2008 jashtë ujrave territoriale kroate rëndoi jo vetëm marrëdhëniet e Kroacisë me fqinjët e saj të BE-së, Italinë dhe Slloveninë por edhe me BE-në vetë. Zyrtarisht Zagrebi foli për një zonë ekologjike për mbrojtjen rezervat e peshkut në Adriatik. Njëkohësisht Kroacia hodhi pretendimin për të drejta ujore ndërkombtare përtej zonës së saj territoriale. Zona e shpallur përfshin 25.000 kilometra katror. Në lidhje me këtë, pala kroate apeloj të drejtën ndërkombëtare të sovranitetit dhe terhoqi vëmendjen se tashmë precedent për një rast të tillë në rajon ka patur – edhe Italia dhe Sllovenia kanë deklaruar një zonë të njëanshme të këtij lloji.

Sllovenia dhe Italia e kthyen këtë pretendim si jo të rregullt duke theksuar se nuk kanë provuar asnjëherë, me justifikimin për mbrojtjen e rezervës së peshkut në Adriatik të zgjerojnë të drejtat ujore të njëanshme dhe kështu të krijojnë të vërteta të reja ta së drejtës ndërkombëtare. Sllovenia kujton më tej se përmes kësaj Kroacia ka ashpërsuar prej vitesh mosmarrëveshjen e pazgjidhshme në lidhje me vijën kufitare në gjirin e Piranit.

Më në fund Kroacia ndryshoi qëndrim dhe deklaroi se zona mbrojtëse nuk merrte vlerë për shtetet antare në BE. Në kuadër të samitit të BE-së, Komisioni Evropian reagoi në lidhje me ndryshimin e qëndrimit të Kroacisë për mosmarrëveshjet mbi zonën mbrojtëse të peshkimit në Adriatik dhe e atestoi Kroacinë si ngatrestare në nivel të BE-së.

"Ky vendim ishte i drejtë në frymën e interesit kombëtar- dhe ky është anëtarësimi në BE", tha Kryeministri kroat Ivo Sanader në Bruksel. Barroso njoftoi se Komisioneri për Zgjerimin e BE-së, Olli Rehn në vjeshtë të vitit 2008, do të prezantojë një plan të saktë kohor për përmbylljen e bisedimeve për anëtarësim. Ai ka „besim të plotë se Kroacia do t'i përmbushë kushtet për antarësim", si për shëmbull reformat në sistemin e drjtësor dhe ristrukturimin gjithnjë në mungesë të kantjereve detare, tha Kryetari i Komisionit.

Edhe pse Sllovenia për këtë arsye e ka vënë në dyshim mbështetjen e saj për anëtarësimin e Kroacisë, marrëdhëniet mbeten të qëndrueshme për shkak të gërshetimeve të mëdha ekonomike dhe kulturore midis vendeve.

Taktikë:

Ju jeni përfaqësuese/përfaqësues i vendit tuaj. Qellimi juaj është antarësimi i Kroacisë në Bashkimin Evropian! Ju duhet të bindnin partnerët tuaj në bisedime se Kroacia e ka arritur statusin e pjekurisë për anëtarësim. Referojuni sukseseve të mëdha të punës së Qeverisë dhe informoni në lidhje me reforma të tjera të planifikuara. Reforma politike të domosdoshme do të zbatohen dhe deficitet demokratike në Kroaci do të mënjahohen. Liria e shtypit u siguroa, administrata, drejtësia dhe mediat punojnë në pavarësi të plotë. Vini theksin tek gadishmëria e pakufizuar për bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar. Kroacia mbështeti pa kushte NATO-n gjatë konfliktit në Kosovë edhe në lidhje me Paktin e Stabilitetit për Ballakanin, Kroacia kërkon të luajë rolin e një faktori stabilizues.

Nënvizoni faktin se Kroacia është pjesë përbërëse e Evropës si nga pikëpamja gjeografike ashtu edhe historike e kulturore. Referojuni shtetit fqinj verior, Sllovenisë. Kroacia ka një histori shumë të njëjtë dhe të re me të. Trajtimi jo i barabartë midis Sllovenisë dhe Kroacisë nuk përbën justifikim për ju. Përveç kësaj, antarësimi i Kroacisë do të ndikojë pozitivisht në rajonin e shkatëruar nga lufta dhe mund të shërbejë si një shëmbull i mirë për vendet e tjera. Përmes kësaj shprehni edhe rolin tuaj të plotëpërgjegjshëm për rajonin.

Gjatë bisedimeve mbani kontakte me Gjermaninë, Austrinë dhe Italinë. Me këto shtete keni patur tradicionalisht marrëdhënie të mira. Edhe me vendet e reja antare, Slloveninë dhe Hungarinë keni kontakte të mira.

Siguroini partnerët tuaj në bisedime për gadishmërinë pa kushte në përmbajtjen e kritereve për antarësim të Kopenhagenit.

Vini theksin mbi gadishmërinë për bashkëpunim me Gjykatën e Krimeve të Luftës në Hagë, gjithashtu tregoni edhe tendencën tuaj kundër gjykimeve paushale. Sinjalizoni gadishmërinë tuaj për zgjidhje mirëkuptuese në lidhje me mosmarrëveshjen mbi vijën kufitare me Slloveninë.

Kosova

Kryeqyteti:	Prishtina
Forma shtetërore:	Republikë
Sipërfaqja:	10.887 km ²
Banorë:	2,127 Mln.
PBB / banor:	-
Rritja ekonomike:	-
Papunësia:	35 – 50%
Gjuhët:	shqip, serbisht
besimet fetare:	muslimane, të krishterë ortodoksë, të krishterë katolikë
Grupime etnike:	92% shqiptarë, 5,3% serbë, 2,7% turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkali
Kryetari i shtetit:	Fatmir Sejdiu
Kryetari i qeverisë:	Hashim Thaci

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni i/e deleguar i/e Kosovës në bisedimet me BE-në dhe synoni anëtarësimin sa më të shpejtë të mundshëm të shtetit Tuaj të ri. Për këtë mund të përdorni informacionet e mëposhtme nga historia, politika dhe ekonomia e vendit Tuaj. Natyrisht Ju nuk duhet të fshihni apo të zbkuroni ndonjë të dhënë, që mund të mos jetë shumë e favorshme. Mbani parasysh: qëllimi Juaj është anëtarësimi i shpejtë i vendit Tuaj në BE!

Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë shkaktoi në pothuaj 20 vitet e fundit shumë vuajtje dhe gjakderdhje. Me ditën e shpalljes së pavarësisë të Kosovës komuniteti ndërkombëtar i shteteve shpreson që të mund të lihen pas fantazmat e të shkuarës dhe të hidhet shikimi drejt një të ardhmeje paqësore. Bashkimi Evropian uron për të gjithë Ballkanin një të ardhme në paqe, stabilitet dhe begati ekonomike. Ky është qëllimi që edhe Ju ndiqni.

Serbët dhe shqiptarët e Kosovës kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të ndarë në lidhje me çështjen e statusit ndërkombëtar, që duhet të ketë kjo provincë. Kosova ka shpallur pavarësinë e saj, ndërsa Serbia vazhdon ta konsiderojë Kosovën si pjesë të territorit të vet. Që prej vitit 1999 Kosova është nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. Bazë për këtë është Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, datë 10 qershor 1999. Së këtëjmi u krijua Misioni i Kombeve të Bashkuara UNMIK (*United Nations Interim Administration Mission in Kosovo*). Pas ngjarjeve të luftës UNMIK mendohet të krijojë një administratë tranzitive për rivendosjen e raporteve normale jetësore. Në datën 24 tetor 2005 Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara dha dritën jeshille për fillimin e bisedimeve në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës.

Kështu ndër të tjera pati konsensus, që çdo zgjidhje duhet të kontribuojë në përforcimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal, që do të thotë se përjashtohet mundësia e rikthimit të Kosovës në situatën e para vitit 1999, e ndarjes apo bashkimit me një shtet të tretë. Ky konsensus qëndronte edhe në faktin që një rol qendror i takonte edhe mbrojtjes së të gjitha pjesëve të popullsisë dhe pakicave në Kosovë.

Që prej fillimit të vitit 2006 i dërguari special i Kombeve të Bashkuara u përpoq që me anë bisedimesh të drejtpërdrejta mes Beogradit dhe Prishtinës të arrinte në një

konkluzion të përbashkët në lidhje me statusin e ardhshëm të provincës, e cila që prej vitit 1999 ndodhej nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. E megjithatë anëtarët e Këshillit të Sigurisë nuk mundën të binin dakord për një rezolutë sigurie mbi bazën e propozimeve të Ahtisaari-t.


Po kështu përpjekjet e Bashkimit Evropian, Ruisë dhe SHBA-ve për të ndërmjetësuar mes Beogradit dhe Prishtinës për zhvillim bisedimesh nuk patën rezultat.

Gjatë muajve të fundit në Kosovë ka patur ndryshime shumë të thella: pas bisedimesh shumëvjeçare, por gjithsesi të pasuksesshme, mes Serbisë dhe shqiptarëve të Kosovës në lidhje me statusin përfundimtar, më 17 shkurt 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia. 22 shtete të Bashkimit Evropian, mes të cilave edhe Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Italia e kanë njohur ndërkohë pavarësinë e Kosovës. Në këtë mënyrë u mbyll ky proces i gjatë dhe i vështirë i shpërbërjes. Bashkimi Evropian shpreson që në këtë mënyrë në rajon të vendoset qetësia.

Pavarësia e Kosovës

Që në momentin e shpalljes së pavarësisë në shkurt Parlamenti dhe udhëheqja politike e Kosovës morën përsipër realizimin e standardeve ligjore dhe demokratike në vendin e tyre. Këtë e nënvizon edhe Kushtetuta e hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Kjo Kushtetutë e konsideron Kosovën si atdheun e të gjithë qytetarëve të saj dhe formulon qartë njohjen dhe respektimin e shtetit ligjor, demokracisë dhe multi-etnicitetit.

Rëndësi të veçantë komuniteti ndërkombëtar i ka kushtuar vazhdimisht mbrojtjes së minoriteteve, që ka qenë edhe objekti kryesor i bisedimeve të më shumë se dy viteve, në mënyrë që të arrihej një zgjidhje konsensuale në lidhje me statusin. Njerëzit në Kosovë duhet të përmirësojnë konkretisht standardet e jetesës së tyre dhe BE kërkon ta mbështesë këtë shtet të ri në rrugën e vet.



Burimi: <http://de.ëikipedia.org/~>

Deri më tani marrëdhëniet me jashtë kanë qëndruar në hijen e konfliktit për njohje diplomatike. Një sërë shtetesh mes të cilave edhe Gjermania, kanë hapur që në shkurt 2008 përfaqësitë e tyre në Prishtinë. Me përjashtim të Serbisë, të gjitha shtetet fqinje, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia, kanë lidhur marrëdhëniet diplomatike me Kosovën. Pikërisht njohja e Kosovës nga ish-Republikat jugosllave e ka zemëruar dhe njëkohësisht edhe zhgënjyer shumë Serbinë.

Serbia shënoi një sukses ndërkombëtar në tetor 2008 kur Kombet e Bashkuara vendosën me shumicë të verifikonin pavarësinë e Kosovës përmes Gjykatës Ndërkombëtare. Nga 192 shtete anëtare 77 votuan pro këtij vendimi, ndërsa 74 – mes tyre shumica e shteteve të BE-së – absetnuan.

Një aleat i rëndësishëm i Kosovës janë Shtetet e Bashkuara, të cilët kanë një bazë relativisht të madhe ushtarake në Kosovë; ndërsa Rusia, anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara mbështet Serbinë, po kështu Kina vazhdon të mbajë një pozicion refuzues. Kështu që për Kosovën, në këto rrethana, rruga drejt Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare mbetet e bllokuar.

Brenda për brenda Jugosllavisë Kosova ishte rajoni më i varfër. Shkak për këtë – krahas prapambetjes së përgjithshme të rajonit – ishte edhe një politikë e munguar ekonomike dhe strukturore në 30 vitet e shkuara. Në Kosovë ishte vendosur kryesisht industria që prodhonte lëndë të parë dhe shumë pak industri përpunuese. Në fakt Kosova subvencionohej nga republika të tjera jugosllave, por megjithatë në vitet gjashtëdhjetë – shtatëdhjetë investicionet kapnin vetëm 50% të vlerës mesatare jugosllave.

Në vitin 1989 të ardhurat mujore në Kosovë arrinin mesatarisht 454 dinarë (Slloveni: 1180; Kroaci: 823; Serbia Qendrore: 784). Në fillim të viteve 90-të prodhimi ekonomik i Kosovës u përgjysmua sërish. Arsye për këtë ishin shpërbërja e ish-zonës ekonomike të Jugosllavisë si pasojë e luftërave civile, sanksioneve ndërkombëtare si dhe aksesit të munguar në tregjet dhe financat e huaja. Përmes konfliktit serbo-shqiptar 1998/99 pati edhe një rënie të mëtejshme me 20% – nga një nivel, që gjithsesi ishte shumë i ulët.

Pas përfundimit të luftës, Kosovës iu vunë në dispozicion rreth 2 mrd euro si fonde ndihme. Deri më tani janë ndërtuar rishtas apo rindërtuar rreth 50.000 shtëpi, 1400 km rrugë si dhe spitale dhe shkolla. Kjo solli një hop në zhvillimin e pasluftës në sektorët e ndërtimit, tregtisë dhe administratës publike.

Ekonomia

Ekonomia e Kosovës mbështetet nga njëra anë në sipërmarrje të vogla familjesh fermere – më së shumti mbillen drithëra (grurë, misër) lule dielli, kolzë, panxhar sheqeri dhe hardhi rrushi – si dhe në sipërmarrje private në sektorin e tregtisë dhe të ndërtimit. Sektori industrial karakterizohet nga fusha të tilla si minierat, kimia, elektronika, tekstilet, lëndët e ndërtimit dhe druri. Në sektorin e minierave nxirren bakër, qymyr, plumb dhe zink. Në tërësi sektori industrial ka një nivel të dobët zhvillimi.

Rritja ekonomik është vlerësuar për vitin 2002 me 2,2%, 2003 me 3,1%, 2004 me 3,2% 2005 me 3,5 dhe 2007 me pothuaj 3,5 – 4,2%. Në të njëjtat periudha inflacioni është ulur nga 3,6% (2002) në 1,1% (2003) resp. 1,5% (2004). Në vitin 2005 madje u regjistrua një ulje çmimesh në vlerën e -0,5%.

Monedha zyrtare është euro. Mejjithatë Kosova nuk është ende vend anëtar i Komunitetit Monetar Evropian. Monedha D-Mark, vendosur dikur si monedha e dytë në vend, u vu në përdorim më 1999 nga administrata e Kombeve të Bashkuara dhe u zëvendësua më pas nga euro. Në zona me popullsi dërmuese serbe mund të paguhet edhe me dinarë serbë.

Ekonomia varet në një masë jashtëzakonisht të madhe nga prurjet financiare nga jashtë (fonde ndihmë, transfertat kapitalesh nga emigrantët). Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave të Kosovës transfertat e emigrantëve jashtë vendit janë më të larta se vlerat e arritura brenda Kosovës. Duke qenë se fondet e ndihmës janë në rënie dhe hyrja në tregun e punës së BE-së po bëhet më e rëndë edhe për kosovarët, kjo strukturë gjithësi e pashëndetshme fsheh risqe të shumta e të konsiderueshme.

Papunësia dhe varfëria

Momentalisht në një milionë njerëz të aftë për punë ka vetëm 325.000 vende pune (përfshirë këtu edhe ato të paregjistruar e ekonomisë informale). Krahas kësaj çdo vit i shtohen tregut të punës dhe 36.000 forca të reja pune. Vitet e fundit papunësia është e nivelit të lartë por ka shënuar ulje të lehta (2001: 57,1%, 2002: 55%, 2003: 49,7%. Në vitin 2008 papunësia qëndron mes shifrave 42 dhe 43%. Grupmosha mes 16 dhe 24 vjeç është e prekur në një masë 60% nga papunësia. Sipas të dhënave të Bankës Botërore 37% e popullsisë jetojnë poshtë kufirit të varfërisë (të ardhurat ditore për të rritur janë poshtë 1,37 euro) ndërsa 15% poshtë kufirit të varfërisë ekstreme (të ardhurat më pak se 0,93 Euro në ditë për të rritur).

Nga ky nivel varfërie janë të prekur para së gjithashmë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, banorët e qyteteve dhe komunave të vogla apo periferike si dhe ata që bëjnë pjesë në pakicat joserbe, si p.sh romët apo muslimanët sllavë (boshnjakët). Varfëria në Kosovë ka ndikim edhe në fusha të tjera: sektori i edukimit është i nënfinancuar, nëpër shkolla mësimi jepet me tre-katër turne. Informacionet mbi shëndetin e banorëve janë ndër më të këqiat në Evropën Juglindore.

Infrastruktura

Hekurudha në Kosovë është ndër më të vjetrat e rajonit dhe daton vitin 1874 kur otomanët ndërtuan segmentin Üsküp (sot Shkup) deri në Polje/Kosovë. Rrjeti hekurudhor, që shërben për qarkullimin e pasagjerëve e që deri më sot nuk është zgjeruar në mënyrë domethënëse dhe nuk është elektrifikuar, ka një gjatësi prej vetëm 333 km, të cilat pas luftës më 1999 nuk mund të përdoren më në masë të plotë, dhe si për nga infrastruktura e shinave ashtu edhe për nga gjendja e trenave janë në një gjendje tejte të keqe ndërtimore, teknike dhe teknologjike. Në Kosovën e Veriut banuar më së shumti nga serbët që prej marsit 2008 këtë shërbim e ka marrë përsipër shoqëria serbe e hekurudhave Železnice Srbije.

Aktulisht ka 1.925 km rrugë kryesore dhe dytësore, autostrada nuk ka. Gjithësi ekziston një projekt për një autostradë nga Merdara drejt Morinës, e cila mendohet të lidhë Serbinë me Shqipërinë nëpërmjet Kosovës. I vetmi aeroport civil në Kosovë është ai i Prishtinës. Në vitin 2002 ai shënonte qarkullimin e gjithsej 844.098 pasagjerëve; në këtë periudhë kishte 4171 fluturime nga dhe në drejtim të Prishtinës. Shumë shoqëri ajrore të mbarë Evropës e kishin Prishtinën destinacion të tyre.

Taktika:

Ju jeni përfaqësues/e i/e vendit Tuaj. Mbani gjithnjë parasysh: objektivi Juaj është anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian. Ju duhet të bindni partnerët Tuaj në bisedime nga të gjitha anët e Bashkimit Evropian në lidhje me pjekurinë e Kosovës për anëtarësim. Sillni në vëmendjen e tyre sukseset e para të Qeverisë dhe shpjegoni se cilat janë reformat, që do të duhet të ndërmerrni më tej.

Kosova ka shpallur më 17 shkurt 2008 pavarësinë e saj, e cila u njoh nga rreth 500 shtete por jo nga vendi, të cilit i përkiste deri në atë moment. Zyrtarisht Kosova, sipas Rezolutës 1244 të OKB-së, bën pjesë në vendet potencialisht candidate për anëtarësim në BE.

Por në rrugën për anëtarësim në BE për momentin ka pengesa të shumta. Në fakt shumica e shteteve të BE-së e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur. Por megjithatë Greqia, Rumani, Sllovakia, Spanja dhe Qipro kanë refuzuar ta njohin, fakt ky që në pjesën më të madhe ka të bëjë me çështje të politikës së brendshme. Por pa njohjen nga të gjitha shtetet e BE-së nuk mund të mendohet hapja e bisedimeve të anëtarësimit. Për anëtarësimin e vendeve të reja anëtare është i nevojshëm miratimi nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Përpiquni pra para së gjithash të arrini njohjen e pavarësisë nga të gjitha shtetet e BE-së.

Krahas kësaj edhe tensionet diplomatike brenda për brenda BE-së janë shumë të fuqishme. Kështu Parlamenti i Serbisë ka vendosur, që të gjitha marrëveshjet që do të lidhë Serbia duhet të marrin në konsideratë njësinë shtetërore të këtij vendi. Pra bisedimet mes BE-së dhe Kosovës do të bënin të pamundur lidhjen e marrëveshjeve të tjera me Serbinë. Forcat radikale në Serbi ngulin këmbë që Serbia mund të bëhet anëtare e BE-së vetëm me Kosovën në përbërje të saj. Ndërsa forcat e moderuara ndjekin linjën e mundësisë së një anëtarësimi të Serbisë në BE, për të penguar më pas që Kosova të bëhet anëtare e BE-së.

Edhe Kosova vetë vazhdon të përballet me probleme të shumta. Kështu strukturat demokratike nuk janë shumë të zhvilluara. Panorama e partive është ende e paqëndrueshme dhe përfaqëson para së gjithash grupime etnike. Korrupsioni është shumë i përhapur dhe ka një nivel shumë të lartë të ekonomisë informale. Tensionet etnike në vend janë të mëdha, pasi minoriteti serb është në mënyrë strikte kundër pavarësisë së Kosovës. Po kështu problemet ekonomike janë masive. Kështu Kosova nuk ka një furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike. Shumica e popullsisë është e papunë. Një pjesë e madhe e popullsisë jeton në varfëri.

Bëni të qartë, që Ju nuk druheni përpara përpjekjeve, që të mund të arrini ndryshime në vendin Tuaj.

Kështu veçanërisht Kushtetuta e miratuar me rastin e pavarësisë, e cila u garanton të drejta të mëdha minoriteteve, është një shenjë pozitive për një fillim të ri në Kosovë. Në kuadër të Misionit të BE-së EULEX Ju do të mbështeteni tanimë përmes forcash të policisë, gjykatës, prokurorë dhe nëpunës doganash.

Meqenëse Kosova në pjesën më të madhe është e besimit musliman, mund të përdoren argumenta kundër anëtarësimit në BE të ngjashme me ato në rastin e Turqisë. Megjithëse duke u nisur nga fakti që Kosova është një vend i vogël, kjo nuk do të kishte shumë të ngjarë të ndodhë. Krahas kësaj, në Kosovë, sikurse edhe në Shqipëri dhe Bosnje-Hercegovinë, vende këto që gjithashtu kanë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë të besimit musliman, zor se ka rryma islamiste.

Me shtetet Tuaja fqinje Malin e Zi, Shqipërinë dhe Maqedoninë Ju keni kontakte të mira. Në debatin për emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë Ju mbështesni Maqedoninë, por nga ana tjetër nuk doni të rrezikoni investimet nga ana e Greqisë, ndaj edhe në publik merrni një pozicion disi të tërhequr, kur bëhet fjalë për t'u shprehur në lidhje me këtë çështje.

Mbështesni me forcë interesat Tuaja dhe bëni të qartë, që Ju keni ndërmarrë tashmë në mënyrë të suksesshme hapat e parë në drejtim të Bashkimit Evropian dhe se për Ju mbështetja e mëtejshme e BE-së është shumë e rëndësishme. Dhënia e statusit të një vendi kandidat do të ishte një shenjë e rëndësishme për inkurajimin e përpjekjeve të mëtejshme të Kosovës dhe do të mundësonte ruajtjen e një ritmi të lartë në përafrimin me BE-në.

Mali I Zi (Crna Gora)

Kryeqyteti:	Podgorica (136.000 banorë)
Forma shtetërore:	Republikë
Sipërfaqja:	13.812 km ²
Banorë:	601.000
PBB/banor:	32.30 US-Dollar
Rritja ekonomike:	16,0%
Papunësia:	9,0%
Gjuhët:	malazeze (serbisht), shqip, hungarisht
Besimet fetare:	shumica ortodoksë të krishterë, katolikë, muslimanë
Grupe etnike:	malazezë 267.669 (43,16%);serbë (32,00%), boshnjakë (7,77%), shqiptarë (5,03%), myslymanë sllavë (3,97%), kroatë (1,10%), romë dhe sinti (0,42%) të tjerë nuk japin as shtetësinë as të dhëna, (6,56%). Për veç kësaj në Malin e zi jetojnë edhe të dëbuar nga atdheu i tyre të cilët nuk merren parasysh gjate regjistrimit të popullsisë pasi kanë statusin e refugjatit. Këtu bëhet fjalë për më shumë se 6.926, pjesa më e madhe refugjatëve janë serbë nga Bosnja dhe Hercegovina, 16.137 dhe refugjatë nga Kosova (pjesa më e madhe romë dhe serbë)
Kryetar shteti:	Filip Vujanoviv
Kryetar qeverie:	Milo Djukanoviv

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni e/i deleguar i Malit të Zi gjatë bisedimeve me BE-në. Ju synoni anëtarësimin e shpejtë të vendit tuaj në BE. Gjatë bisedimeve mund të shfrytëzoni të dhënat e mëposhtme nga historia, politika dhe ekonomia e vendit tuaj. Natyrisht Ju lejohet të fshihni ose të përmirësoni disa të dhëna pak të këndshme. Mos harroni, qëllimi Juaj është anëtarësimi i shpejtë i vendit Tuaj në Bashkimin Evropian!

Mali i Zi (në gjuhën malazeze/serbe Crna Gora, serb.-kyrilisht Црна Гора, në gjuhën shqipe Mali i Zi) është që prej 3 qeshorit 2006 një shtet i pavarur i Evropës Juglindore i cili kufizohet me Kroacinë, Bosnjën-Hercegovinën, Serbinë, Kosovën si dhe Shqipërinë. Në jugperëndim kufizohet nga deti Adriatik. Shteti ballkanik me rreth 622.000 banorë (regjistrimi i popullsisë 2003: 620.145) dhe me një sipërfaqe prej 13.812 km² është një ndër shtetet më të vogla të Evropës. Kryeqyteti është Podgorica. Mali i Zi është anëtar i Kombeve të Bashkuara, i OSBE/së dhe i Këshillit Evropian. Përveç këtyre synohet edhe anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Mali i Zi, në krahasim me vendet e tjera evropiane është një vend malor pjesërisht i banuar në pjesën juglindore të Malësisë së Dinarit. Bregdeti i vendit karakterizohet nga rëpira dhe gjire (p.sh. gjiri i Kotorrit) pjesë e bregdetit mesdhetar (Adriatiku). Veçanërisht krahina e Krsterit dhe pjesës perëndimore të Mailit të Zi (Orjen, Lovćen) janë pak të populluara. Vetëm Poljen ofron në këtë zonë një truall të shfrytëzueshëm për mbjellje bujqësore (Grahovo, Cetinje). Në pjesën veriore të vendit gjenden majat më të larta të Mailit të Zi dhe të gjithë Malësisë Dinare. Këtu ndodhen edhe masivet malore qëndrore, Prokletije me malin më të lartë në vend, Zla Kolata (2.534 m) si dhe masivi Durmintor.

Montenegro, fjalë për fjalë i përkthyer do të thotë „mal i zi“, ndërsa emri i vendit Crna Gora mund të përktheht „malësi e zezë“, „malësi me pyllëzim të zi“ ose „pylli i zi“. Emërtimi ndërkombëtar Montenegro nuk vjen nga italishtja por nga gjuha veneciane. Në Hungarinë-Austriake të shekullit të 19-të flitej për malin e zi (Schëarzenberg).

Banorët e Malit e Zi konsiderohen si 43% malazezë, 32% serbë, rreth 8% boshnjakë, 5% shqiptarë dhe 4% myslymanë sllavë. Çështja nëse populli malazez është një popull më vete ose pjesë e popullit serb, është për vetë popullatën atje një pikë e diskutueshme; në veçanti konservatorët serbë e konsiderojnë pjesën më të madhe të Malit të Zi si pjesë përbërëse e popullit serb.

Po kështu edhe tek minoritetet e mëdhaja, kryesisht tek ato në veri të vendit, (pjesa malazeze e Rashkës, më saktë e Sanxhakut) ku jetojnë boshnjakët dhe myslymanët sllavë, ka preferenca të ndryshme në lidhje me emërtimin e shtetësisë së tyre. Pjesë tjetër e minoritetit janë edhe shqiptarët të cilët banojnë në krahinat përgjatë kufirit me Shqipërinë dhe me Kosovën. Në komunën e Ulqinit ata përbëjnë shumicën e popullsisë me 72 përqind (regjistrimi i popullsisë 2003).

Sipas Kushtetutës së 19 tetorit 2007, gjuhët zyrtare të Malit të Zi janë gjuha malazeze, serbe, bashnjake, shqipe dhe kroate. Neni 11 i ligjit mbi minoritetet, aprovuar në datë 11 maj 2006 lejon në të kundër përdorimin e gjuhëve minoritare si gjuhë zyrtare vetëm në rajonet ku këto përbëjnë shumicën ose një pjesë domethënëse të popullsisë, çka u jep zyrtarëve malazezë hapësirë veprimi. Ligji mbi minoritetet i miratuar në vitin 2002 nga Federata e Shteteve të Serbisë dhe Malit të Zi parashikonte se popullsia minoritare duhet të përbëntë 15% të gjithë popullsisë së komunës bazuar në regjistrimin e popullsisë, për të njohur gjuhën e tyre si gjuhë zyrtare në nivel komuniteti. Alfabeti latin ashtu si ai kiril janë në përdorim.

Për sa i përket emërtimit të gjuhës ashtu si edhe emërtimit të shtetësisë mendimet janë të ndryshme. Gjatë regjistrimit të popullsisë në vitin 2003, 63,49% e popullsisë dhanë gjuhën serbe dhe 21,96% atë malazeze si gjuhë mëmë. Rreth 75% e banorëve të Malit të Zi i përkasin Kishës Serbe-Ortodokse me Metropolinë Amfilohije (Radovic) si qëndër e Metropolisë. Përkrah kësaj ekzisojnë edhe Kisha ende e panjohur malazeze Autoqefale Okumene dhe Konike e themeluar me 1993 nga Kisha Ortodokse. Përveç besimtarëve ortodoksë ekziston edhe minoriteti myslyman që përbën 12% të popullsisë dhe disa mijëra katolikë, pjesa më e madhe kroatë dhe shqiptarë. Komunitetetet protestante përbëhen nga më pak se 1000 antarë.

Që prej viteve 1990, Mali i Zi konsiderohet si qëndra ndërkombëtare e kontrabandës së cigareve. Opozita e sheh implikimin e Kryeministrit Đukanović në kontrabandë si një arsye për fushatën e tij të pavarësisë. Në lidhje me këtë, Kryeministri malazez Milo Đukanović, pas rizgjedhjes së tij në detyrë, në shkurt 2008, u vu vullneatarisht në dispozicion të hetuesëve nga Bari/Itali në fund të marsit 2008. Pyetësori përbëhej nga 80 pyetje. Me antë të një marrëveshjeje me Gjykatën e Barit, e cila kishte vënë si kusht përgjigjen vullnetare të Đukanović, u evitua publikimi i përmbajtjes së pyetësorit. Seancat pyetësore duhet të kishin filluar që në verën e vitit të shkuar 2007, por u shlytë për në mars atëherë kur Milo Đukanović pas tërheqjes së kolegut të tij partiak për shkaqe shëndetësore u riemërua Kryeminister.

Ende sot Mali i Zi trajton në vazhdimësi çështje mbi kontrabandën e cigareve, lëndëve narkotike, armëve, mishit të bardhë, automjeteve të vjedhura nga vendet e BE-së dhe vrasjet me pagesë të pazgjydhshme të krimit të organizuar. Si shëmbull për këtë shërben vrasja e pashpjegueshme e Duško Jovanović, kryeredaktorit të gazetës Dan me nota

kritike ndaj Qeverisë, i cili u qëllua natën e 24-25 majit 2004. Hetimet kundër kryetëdyshuarit u mbyllën për mungesë provash.

Pauritë minerale më të rëndësishme janë boksi, minerale hekuri dhe linj; në industri sektorët më të rëndësishëm të prodhimit janë tabaku, alumini, përpunimi i kripës. Ekonomia bujqësore përbëhet nga kultivimi i perimeve, drithrave, patates, tabakut, verës, agrumeve, ullinjëve dhe i fiqëve. Përveç këtyre fushave, rol të madh në Malin e Zi luan edhe turizmi. 15% e Prodhimit të Brendshëm Bruto sigurohet nga ky sektor; sipas World Travel & Tourism Council (WTTC), Mali i Zi është prej vitesh një ndër tre vendet turistike me rritje më të madhe kudo në botë. Në vitin 1999 u fut si monedhë marka gjermane. Në vijim të zëvendësimit të markës gjermane me euron, që prej vitit 2002 shërben euro si monedhë vendase. Duke qënë se vendi nuk merr pjesë në Bashkimin Monetar Evropian nuk ka të drejtën e shtypjes së monedhës së vet euro. Në fund të vitit 2005 u publikuan pullat e para që pas vitit 1913.

Taktikë:

Ju jeni përfaqesuese/përfaqësues i vendit tuaj. Mos harroni: qëllimi juaj është antarësimi i Malit të Zi në Bashkimin Evropian! Atëherë duhet të bindni partnerët e bisedimeve mbi pjekurinë e Malit të Zi. Referojuni sukseseve të punës së Qeverisë suaj dhe informoni në lidhje me reforma të tjera të planifikuara.

Pas marrjes së pavarësisë Mali i Zi ka bërë hapa të mirë përpara për krijimin e nevojshëm të kushteve të përgjithshme ligjore dhe institucionale. Në tetor Parlamenti pranoi Kushtetutën e cila qëndron në harmoni me standartet evropiane. Vendi ka ecur përpara për sa i përket reformave në administratë dhe në sistemin ligjor. Partitë politike më të rëndësishme pranuan një deklaratë mbi parimet kushteuëse bazë të shtetit të së drejtës dhe u zotuan t'i pasqyronin këto parime në Kushtetutë. Kjo mundësoi anëtarësimin e vendit në Këshillin Evropian. Hapa përpara janë bërë edhe në kornizen e nevojshme për respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve. Mali i Zi angazhohet në bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore dhe ka ratifikuar Marrëveshjen e CEFT-ës.

Por reforma në sistemin drejtësor sapo ka filluar ndërkohë që korrupsioni është ende shumë i përhapur dhe administrata publike shumë e dobët.

Mali i Zi ka bërë përparime në hapjen e tregur ekonomik funksional edhe pse rritmi është ngadalësuar. Kërkohen reforma rrënjësore për krijimin në vend të një situat e cila do t'i bënte ballë me terma aftgjatë presionit të konkurrencës dhe fuqisë së tregut brënda Bashkimin Evropian.

Sabiliteti makroekonomik është rritur. Rritja e shpejtë ekonomike ka dhënë frytet e saj në hapjen e vendeve të reja të punës ndërkohë që inflacioni mbetet i sfumuar. Investimet e drejta të huaja kanë shkaktuar kthesën rrënjësore ekonomike. Vendi ka ndjekur një politikë financiare të kujdesshme rezultat i së cilës ishte një buxhetin shtetëror me tepriçë. Hapja e tregtisë dhe përafrimi me rregullat e OBT-së kontribuan në integrimin ekonomik. Vendi ka shënuar disa suksese gjatë përafrimit me standartet evropiane dhe ndërtimit të kapaciteteve administrative çka mundësoi nënshkrimin e MSA-së me BE-në. Në sektorin doganor, tatimor, konkurrencë, shkëmbim i lirë kapitali dhe bujqësi ka patur arritje pozitive. Në sektorin social, atë të politikës së punësimit, energji, mjedis si dhe sektori i drejtësisë, lirisë dhe sigurisë ka ende shumë punë për të bërë. Mali i Zi duhet të përmirësojë më tej kapacitetet ligjore, politike dhe administrative për të mundësuar një implementim sa më të suksesshëm të MSA-së.

Maqedonia

Kryeqyteti:	Shkupi
Forma shtetërore:	Republikë
Sipërfaqja:	25.713 km ²
Banorë:	2,036 Mln.
PBB / Banor:	3.070 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	3,0%
Papunësia:	35%
Gjuhët:	maqedonisht, shqip, turqisht, rumanisht, serbisht, arumune
Besimet fetare:	70% të krishterë ortodoksë, 25% muslimanë, të tjerët katolikë
Grupet etnike:	64,2% maqedonas, 25,2% shqiptarë, 3,9% turq, 2,7% romë, serbë, boshnjakë, arumunë
Kryetari i shtetit:	Branko Crvenkovski
Kryetari i qeverisë:	Nikola Gruevski

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni i/e deleguar i/e Maqedonisë në bisedimet me BE. Ju synoni të arrini sa më shpejt të jetë e mundur anëtarësimin e vendit Tuaj në BE. Gjatë bisedimeve mund të shfrytëzoni informacionet e mëposhtme rreth historisë, politikës dhe ekonomisë së vendit Tuaj. Natyrisht që informacionet më pak të favorshme Ju mund edhe t'i fshihni apo t'i servirni më bukur. Mbani gjithmonë parasysh: Objektivi Juaj është anëtarësimi i shpejtë në BE i vendit Tuaj!

Rreth Maqedonisë

Maqedonia është një shtet kontinental i cili në veri kufizohet me Serbinë dhe Kosovën, në lindje me Bullgarinë, në jug me Greqinë dhe në perëndim me Shqipërinë. Maqedonia ka qenë republika më jugore e ish-Jugosllavisë dhe e shpalli pavarësinë e vet në vitin 1991, pak më vonë se Kroacia dhe Sllovenia.

Gjuha e shumicës së popullsisë është maqedonishtja, ndërsa gjuha me numrin e dytë më të madh të folësve të gjuhës së vet amtare është shqipja. Krahas kësaj në rajone të caktuara flitet edhe turqisht, serbisht dhe gjuha e romëve. Por shumë romë kanë marrë edhe gjuhën e zonës përkatës ku jetojnë.

Shteti dhe politika

Forma shtetërore e Maqedonisë përcaktuar me Kushtetutën Maqedonase të vitit 1991 është Republikë me qeverisje në formën e një demokracie parlamentare. Kushtetua është përpunuar kryesisht nga ish-Presidenti Gjerman Roman Herzog dhe Ministri iu atëhershëm i Drejtësisë në Francë Georges Badinter dhe është miratuar më 17 nëntor 1991. Prej këtij momenti ajo është modifikuar katër herë (1992, 1998, 2001, 2003): më 1992, për të përcaktuar shprehimisht, që vendi nuk do të ngrejë pretendime territoriale kundrejt vendeve të tjera fqinje dhe se nuk do të ndërhyjë në të drejtat e sovranitetit të

vendeve të tjera apo në çështjet e tyre të brendshme (në kontekstin e bisedimeve me Greqinë për shkak të debatit mbi emrin e vendit dhe njohjen ndërkombëtare të tij), më 2001 me qëllim vënien në aplikim të një kuadri kushtetues për zbatimin e Marrëveshjes-Kuadër të Ohrit datë 13 gusht 2001.

Sistemi i partive maqedonase karakterizohet nga një polaritet i dyfishtë: një etniko-kombëtar (sllaomaqedonas dhe shqiptarë) dhe një politik (postkomunist dhe antikomunist).

Politika e brendshme e Maqedonisë

Politika e brendshme e Maqedonisë ka qenë, veçanërisht në vitet '90 të shekullit të kaluar, e karakterizuar para së gjithash nga konflikte të dy kombësive më të mëdha, maqedonasve dhe shqiptarëve. Si pasojë e trysnisë ndërkombëtare Maqedonia kish pranuar gjatë konfliktit të Kosovës më 1999 380.000 refugjatë nga Kosova, gjë që ndryshoi strukturën e thyeshme etnike në vend.

Përmes angazhimit të Presidentit të atëhershëm Boris Trajkovski, të BE dhe SHBA u bë mundur që me anë të Marrëveshjes së Ohrit të arrihej një balancim mes grupeve etnike si dhe çarmatimi i grupimit militant shqiptar.

Duke mbajtur në konsideratë pranimin e synuar në BE Maqedonia ka realizuar një sërë reformash në politikën e brendshme, që mendohet ta sjellin vendin në standardet evropiane, ndër të tjera reformën komunale, të sistemit të shkollave të larta, policisë dhe sistemit të drejtësisë.

Marrëdhëniet me fqinjët

Për shkak të debatit mbi emrin, Greqia u bë pengesë në prill të vitit 2008, që Maqedonia të merrte premtimin për anëtarësimin e dëshiruar në NATO. Politika e jashtme e Maqedonisë karakterizohet fuqishëm nga përpjekjet për t'u bërë anëtar i NATO dhe BE. Por vendi fqinj, Greqia, është kundër pranimin të Maqedonisë nën emrin Republika e Maqedonisë.

Bullgaria ka qenë vendi i parë që ka njohur pavarësinë e Maqedonisë më 15 janar 1992 dhe pikërisht me emrin e vet kushtetues. Por Bullgaria nuk ka pranuar të njohë për një kohë të gjatë ekzistencën e një kombi maqedonas dhe një gjuhe maqedonase të ndarë, gjë që çoi në disa komplikacione gjatë nënshkrimit të marrëveshjes mes dy vendeve.

Bullgaria u jep maqedonasve të drejtën për të marrë nënshtetësinë bullgare, nëse ata mund të dëshmojnë origjinën e tyre bullgare. Deri më tani këtë të drejtë e kanë shfrytëzuar vetëm 10% të të gjithë atyre që e kanë këtë të drejtë, mes të tjerëve edhe ish-kryeministri Ljubčo Georgievski. Në pikëpamje historike vendi i sotëm i Maqedonisë, popullsia e tij, traditat dhe gjuha kanë qenë në fakt të lidhura ngushtë me historinë e Bullgarisë, megjithatë Maqedonia sjell me të drejtë në vëmendje mëvetësinë e saj historike dhe kulturore.

Në vitin 1999 qeveria bullgare dhe ajo maqedonase e lanë mënjanë debatin e tyre disavjeçar në lidhje me gjuhën, e cila kish rënduar shumë marrëdhëniet dypalëshe. Bullgaria njohu fillimisht mëvetësinë e gjuhës dhe kombit maqedonas në mënyrë zyrtare, e më pas Maqedonia hoqi dorë nga çdo lloj ndikimi mbi pakicat maqedonase në Bullgari.

Serbia e sheh në mënyrë kritike fqinjin e saj jugor, pasi Maqedonia u shkëput nga Jugosllavia dhe gjatë konfliktit me Kosovën ka qëndruar në anë të NATO-s. Maqedonia ka njohur pavarësinë e Kosovës në vjeshtën e vitit 2008 së bashku me Malin e Zi. Për shkak të këtyre rrethanave politika maqedonase synon para së gjithash qetësimin e situatave. Krahas përafrimit të vendit me anëtarësimin në BE Maqedonia ka krijuar marrëdhënie të rëndësishme me BE. Kështu Maqedonia mori pjesë me një kontingjent të vogël trupash në Luftën kundër Irakut. Washington-i, pak pas zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara në nëntor 2004, e njohu vendin me emrin „Republika e Maqedonisë“. Kjo çoi menjëherë në një shpërthim në Greqi dhe një citim të Ambasadorit të SHBA në Athinë në Ministrinë e Jashtme të Greqisë. Gjithsesi BE i ka siguruar Greqisë, se nuk do të ndiqte shembullin e SHBA. Ndërkohë janë 121 shtete që kanë deklaruar – ndër të tjera edhe Turqia, Rusia, Kina dhe Kanadaja – se në korrespondencën dypalëshe përdorin emrin kushtetues të Maqedonisë. Rregullorja rreth një emri të njohur sipas të drejtës ndërkombëtare mbetet në këtë mënyrë e paprekur.

Anëtarësimet e synuara në NATO dhe BE janë temat kryesore të politikës së jashtme në Maqedoni.

Në vitin 2004 hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE.

Më 3 prill 2008 Maqedonia mori pjesë me anë të një delegacioni të vet në Samitin e Nato-s në Bukuresht. Delegacioni shpresonte të merrte një ftesë për në Aleancën ushtarake, por që nuk u realizua për shkak të vendosjes së të vetos nga ana e Greqisë me argumentin e debatit ende të pazgjidhur në lidhje me emrin.

Disputi rreth emrit kushtetues „Republika e Maqedonisë“ filloi me shpalljen e pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991 dhe zgjat edhe sot e kësaj dite. Fillimisht Athina kishte frikën e pretendimeve territoriale të Shkupit në lidhje me provincën greke të Maqedonisë. Njohja ndërkombëtare e shtetit të ri vonoi deri në vitin 1993, kur Kombet e Bashkuara e pranuan me emrin FYROM. Në shkurt të vitit 1994 nën drejtimin e kryeministrit Andreas Papandreou Greqia vendosi embargon e tregtisë kundër Maqedonisë.

Në vitin 1995 konflikti nisi të lëvizte. Falë ndërmjetësuesve ndërkombëtarë Cyrus Vance dhe Lord Owen në Shkup dhe Athinë u nënshkrua një marrëveshje interim. Sipas kësaj marrëveshjeje – e cila që prej 2002 nuk është më e vlefshme – Maqedonia ndryshoi flamurin e vet shtetëror: ai nuk tregon me „yllin e Vergina“, por një diell të stilizuar. Fillimisht Maqedonia e plotësoi Kushtetutën e vet me tre pasazhe, ku ajo hiqte dorë nga pretendimet territoriale përkundëjt fqinjëve të saj, nuk do të përzihej në punët e brendshme të tyre dhe në rast të ndryshimit të kufijve, këtë do ta bënte gjithsesi në përputhje me normat ndërkombëtare.

Një zgjidhje e mundshme u propozua nga OJQ e Brukselit "International Crisis Group" (ICG). ICG listoi tre elemente kyçe, që do të mundësonin një bashkim të të dyja palëve pa u dashur që të humbisnin fytyrën. Kështu parashikohej një marrëveshje mes Maqedonisë dhe Greqisë, që i jep të drejtën Greqisë të përdorë për fqinjin e vet termin „Maqedonia e Sipërme“ ose një formulë tjetër të përbërë. Njëkohësisht sipërmarrjet e të dy shteteve lejohet të mbajnë emrin e Maqedonisë për produkte apo shërbime të realizuara në territoret përkatëse. Ndërsa Maqedonia do të njihet nga komuniteti ndërkombëtar me emrin kushtetues „Republika e Maqedonisë“ ("Republika Makedonija").

Një debat tjetër mes Greqisë dhe Maqedonisë u zgjidh: Ylli gjashtëmbëshjetërezesh i Verginas (Dielli i Vergina) ishte një simbol i shtetit të vjetër maqedonas. Greqia nuk e pranonte përdorimin fillestar të këtij simboli në flamurin e Maqedonisë, dhe si pasojë e

trysnisë ekonomike të Greqisë Maqedonia u detyrua ta ndryshonte atë në një diell tetërrezesh.

Maqedonia ishte një ndër zonat më të prapambetura në ish-Jugosllavi më një industri të zhvilluar shumë pak dhe me pasuri të pakta lëndësh të para. Në vitin 2000 9,7% e PBB vinin nga bujqësia dhe vetëm 31,6% në industri. Kuota e papunësisë me vlerën e pandryshuar prej 35% ishte në një nivel shqetësues. Maqedonia vazhdon të jetë një prej vendeve më të varfra të Evropës.

Situata ekonomike

Vendi vuan problemet tipike të një shteti postsocialist si p.sh korrupsionin e theksuar, strukturën e tejfryrë nëpunësish dhe ineficencën e ndërmarrjeve industriale (pjesërisht ende shtetërore). Ekonomia informale në Maqedoni përbën der 45% të PBB.

Papunësia ende shumë e lartë paraqet një prej problemeve kryesore ekonomike. Deficiti i bilancit tregtar është i lartë, importet i tejkalojnë eksportet në një masë prej më shumë se 70%. Ky disproporcion kompensohet vetëm nga transfertat e parave të maqedonasve që jetojnë jashtë vendit.

Në datën 1 janar 2007 u vu në përdorim e ashtuquajtura Flat Tax sipas shembullit slovak, tatim ky që ka vlerën 12% për persona natyrorë dhe korporata në mënyrë të njësuar, dhe që prej 2008 reduktohet në vlerën 10%.

Produkte të rëndësishme eksporti janë ushqimet si vera dhe duhani si dhe hekuri dhe çeliku. Vendet më të rëndësishme destinacion të këtyre eksporteve janë Serbia (31,4%), Gjermania (19,9%), Greqia (8,9%) dhe Kroacia (6,9%). Pjesa më e madhe e importeve në Maqedoni vjen nga Greqia (15,4%), Gjermania (13,1%), Serbia (10,4%), Sllovenia (8,6%) dhe Bullgaria (8,1%).

Taktika:

Ju jeni përfaqësues/e i/e vendit Tuaj. Mbani parasysh: Qëllimi Juaj është anëtarësimi i Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Pra Ju duhet të bindni partnerët Tuaj në bisedime në lidhje me pjekurinë e Maqedonisë për anëtarësim. Sillni në vëmendje sukseset e mëdha të punës së qeverisë dhe sqaroni planet për reformat e mëtejshme.

Maqedonia ka ndërmarrë hapa të tjerë të rëndësishëm, në mënyrë që të plotësojë kriteret për anëtarësimin në BE. Zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit kontribuon në konsolidimin e mëtejshëm të demokracisë dhe shtetit ligjor. Në reformimin e sistemit të drejtësisë është bërë progres dhe në luftën kundër korrupsionit janë arritur rezultate inkurajuese. Respektimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve janë përmirësuar njësoj sikurse edhe marrëdhëniet ndëretnike.

Gjithsesi reformat pësojnë vonesa për shkak të tensioneve të vazhdueshme etnike në vend.

Ju e dini që dialogu mes të gjitha partive në parlament duhet të vijojë në mënyrë paqësore dhe konstruktive.

Duhet treguar kujdes, që të gjithë faktorët politikë të mund të ushtrojnë funksionin e tyre të parashikuar me Kushtetutë dhe të bashkëpunojnë për të garantuar një proces të efektshëm demokratik.

Në këtë mënyrë mund të realizohet progres i mëtejshëm p.sh. në sektorët e policisë dhe drejtësisë, konsolidimit të shtetit ligjor si dhe mbrojtjen dhe mbështetjen e të drejtave të minoriteteve. Korrupsioni në vendin Tuaj është shumë i përhapur dhe në nivelet më të larta në mbarë Evropën.

Maqedonia ndodhet në një nivel të mirë përse i përket zhvillimit të një ekonomie tregu funksionale dhe ka bërë progres në këtë drejtim. Vendi duhet që në terma të paktën afatmesme të jetë në gjendje t'i bëjë ballë presionit të konkurrencës dhe forcave të tregut brenda Unionit, përse kohë që ai vazhdon të zbatojë në mënyrë të vendosur kursin e reformave për të eliminuar pikat shumë të dobëta strukturore.

Papunësia vazhdon gjithsesi të mbetet tejet e lartë dhe funksionimi i ekonomisë së tregut dëmtohet edhe nga mangësitë institucionale. Edhe sistemi i drejtësisë vetë paraqitet vazhdimisht si një sektor në nevojë. Shkalla e garancisë së të drejtës vazhdon të jetë relativisht e vogël.

Tregjet e punës vazhdojnë të funksionojnë në mënyrë jo të kënaqshme.

Por Maqedonia ka bërë përpjekje për të përmirësuar aftësinë e vet në lidhje me obligimet që rrjedhin nga një anëtarësim i mundshëm. Gjithsesi vendi duhet të eliminojë ende mangësi të konsiderueshme në aplikimin dhe zbatimin evektiv të kuadrit ligjor. Mungesa të veçanta ka në burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare.

Përmes një shkëmbimi të gjerë të personelit të kualifikuar si pasojë e ndryshimeve politike janë lënë pas dore përpjekjet për përforcimin e kapaciteteve administrative.

Maqedonia ka mundësi të mira për t'u bërë anëtare e Bashkimit Evropian. Në mënyrë që të mundë të vazhdojë rrugën e saj të nisur e vijuar shumë pozitivisht deri më tani, Juve Ju nevojitet për vendin Tuaj – sado i pasur me kulturë dhe histori që të jetë ai – edhe një ndihmë e konsiderueshme financiare.

Me të drejtë Ju mund ta merrni Maqedoninë si shembull të një vendi në mbrojtje të pakicave. Atje është arritur – edhe pse nuk është gjithmonë e thjeshtë – që etnitë dhe besimet e ndryshme fetare të mund të bashkëjetojnë në mënyrë të paqtë me njëra-tjetrën. Funkzioni i këtij vendi si shembull shpesh nënvlerësohet.

Megjithatë Ju e dini që edhe debatet me Greqinë duhen kapërcyer. Përpiquni të bëni për vete sa më shumë shtete brenda Këshillit.

Serbia/Srbija

Kryeqyteti:	Beograd
Forma shtetërore:	Republikë
Sipërfaqja:	77.474 km ²
Banorë:	7,439 Mln.
PBB/banor:	4.030 Euro US-Dollar
Rritja ekonomike:	5,7%
Papunësia:	18,8%
Gjuhët:	serbisht, shqip dhe hungarisht
Besimet fetare:	shumica të krishterë ortodoksë, katolikë, muslimanë dhe pakica protestantësh dhe hebrejsh
Grupet etnike:	82,7% serbë, 3,9% hungarezë, 1,8% bishnjakë dhe romë
Kryetar shteti	
Kryetar qeverie:	Miko Cvetkovic

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni i/e deleguar i/e Maqedonisë në bisedimet me BE. Ju synoni të arrini sa më shpejt të jetë e mundur anëtarësimin e vendit Tuaj në BE. Gjatë bisedimeve mund të shfrytëzoni informacionet e mëposhtme rreth historisë, politikës dhe ekonomisë së vendit Tuaj. Natyrisht që informacionet më pak të favorshme Ju mund edhe t'i fshihni apo t'i servirni më bukur. Mbani gjithmonë parasysh, objektivi Juaj është anëtarësimi i shpejtë në BE i vendit Tuaj!

Historia e vonë e Serbisë karakterizohet nga roli i saj si shteti më i madh i ish-Jugosllavisë.

Qeveria synon anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe NATO. Me një rritje ekonomike vjetore prej 5% deri 10%, si dhe para së gjithash me investimet e huaja në rritje si pasojë e përpjekjeve të Serbisë për t'u anëtarësuar në BE, ekonomia e Serbisë vlerësohet si ajo me ritmet më të shpejta të rritjes në të gjithë rajonin.

Serbia në një vështrim

Përbërja e popullsisë është e ndryshme në pjesë të ndryshme të vendit. Në Serbinë Qendrore jetojnë kryesisht serbë, e krahas tyre edhe vllahë në lindje dhe verilindje; në juglindje ka bullgarë dhe shpërndarë në të gjithë vendin romë. Në rajonin e Stari Ras jeton edhe një pakicë disi më e madhe boshnjakesh, në Luginën e Preshevës në cepin më jugor të Serbisë së ngushtë ka një pakicë shqiptare.

Vojvodina (**Banati**, **Batcka** dhe **Sirmia**) karakterizohet prej shekujsh nga një përzjerje etnisch – para së gjithash nga Serbë (65,1%), hungarezë (14,3%), sllovakë (2,8%), kroatë (2,8%), vllahë (1,5%), romë (1,4%) dhe më parë edhe rreth 200.000 deri 350.000 gjermanë, të cilët u dëbuan pas Luftës së Dytë Botërore me arsyetimin se kishin tradhëtuar vendin.

Politika dhe administrata

Serbia është një republikë parlamentare me një parlament një-dhomësh, *Narodna Skupština* (përkthimi: Asamble Kombëtare) me 250 deputetë. Ky parlament ushtron legjislativin. Partitë e përfaqësuara aty grupohen në fraksionin e pozitës dhe opozitës. Ekzekutivi udhëhiqet nga një kryeministër (serb. *Predsednik Vlade*, shkurt *Premier*) dhe një Këshill Ministrash, i cili emërohet nga Presidenti i Shtetit, me të cilin ndan kompetenca të caktuara (mbrojtja e vendit, politika e jashtme) por përgjegjësi mban vetëm përpara parlamentit. Presidenti zgjidhet çdo katër vjet drejtpërsëdrejti nga populli. Edhe rizgjedhja është e mundshme. Këtë post e mban që prej vitit 2004 Boris Tadić (DS), i cili më 3 shkurt 2008 u rizgjodh për një mandat të dytë. Në Vojvodinë vazhdon të ketë një parlament rajonal. Ndërsa qeveritë rajonale të Okruzit serb emërohen nga qeveria qendrore.

Partitë më të rëndësishme në Serbi janë Partia Demokratike (DSS, liberale e majtë) dhe Partia Radikale Serbe (nationalistë afensivë). Krahas tyre ka edhe parti të tjera më të vogla.

Nga zgjedhjet parlamentare të parakohshme në janar 2007 doli fitues kampi demokratik. Partitë e alternativës për një lidhje më të ngushtë me BE arritën të merrnin së bashku 150 nga 250 vendet e parlamentit.

Serbia dhe Kosova

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008 brenda qeverisë pati opinione thellësisht të ndryshme në lidhje me afrimin me Bashkimin Evropian. Ndërsa DSS së bashku me partitë e tjera opozitare SRS dhe SPS morën një vendim parlamentar, që kërkonte faktikisht shkëputjen e marrëdhënieve me BE dhe ato shtete të BE, që kishin njohur Kosovën, partitë e tjera qeveritare ngulnin këmbë në vazhdimin e bisedimeve rreth lidhjes së Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me BE, për të cilën ishte rënë tashmë dardur lidhur me pika të rëndësishme.

Vojvodina në veri dhe Kosova në jug përbëjnë sipas Kushtetutës së vitit 2006 dy provincat e pavarura të Serbisë. Që prej vitit 1999, pas mbarimit të luftës së Kosovës, kjo e fundit është nën administrimin e NATO-s. Parlamenti në Prishtinë shpalli në shkurt 2008 pavarësinë e Republikës së Kosovës. Qeveria serbe dhe shtete të tjera e konsideruan procedurën e ndjekur nga Kosova si një shkelje të Resolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe të parimit të integritetit territorial. Më 8 tetor 2008 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një kërkesë të Serbisë, që Gjykata Ndërkombëtare të verifikonte vlefshmërinë e pavarësisë së Kosovës sipas të drejtës ndërkombëtare. Pikërisht një ditë pas kësaj ish-republikat jugosllave të Malit të Zi dhe Maqedonisë e njohën osovën si shtet të pavarur. Një disfatë tjetër e rëndë ndërkombëtare për Serbinë.

Historia e re e Serbisë

Procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë nis në vitin 1991, të gjitha ish-republikat deklaruan njëra pas tjetrës pavarësinë e tyre, përveç Serbisë dhe Malit të Zi. Pas kësaj më 27 prill 1992 Serbia dhe Mali i Zi formuan Republikën Federale të Jugosllavisë. Kjo lidhje në fakt nuk u njoh si pasuesi i vetëm i përligjur juridikisht i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, por mund të vijonte kështu anëtarësimin e Jugosllavisë në Kombet e Bashkuara.

Me shkëputjen e Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnje-Hercegovinës shpërtheu lufta në Jugosllavi. Fillimisht ndërhyri Ushtria Popullore Jugosllave, e cila komandohej nga Beogradi. Por pas njohjes ndërkombëtare të Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjes, ajo duhej të largohej nga këto territore tanimë jo jugosllave. Serbia mbështeti ushtarakisht dhe financiarisht paramilitarët serbë në zonat e luftës në Kroaci dhe Bosnje, por e ndërpreu këtë mbështetje në momentin kur OKB mori vendimin për një embargo tregtie kundër Republikës Federale të jugosllavisë.

Shkaktarët e sanksioneve ishin spastrimet tanimë të njohura etnike kundër muslimanëve boshnjakë. Duke patur ndihmën e Serbisë, serbët e Bosnjës dhe Kroacisë kishin mundur të fitonin zona të konsiderueshme. Por pjesën më të madhe të këtyre zonave e humbën sërish gjatë luftës. Gjatë operacionit ushtarak kroat Oluja në gusht 1995 u dëbuan rreth 200.000 serbë kroatë, ndër të cilët edhe ushtria e mundur e Republikës Serbe Krajina. Kur ushtria kroate dhe forcat e armatosura boshnja përparuan në drejtim të Bosnjes, pati edhe një numër shumë të madh serbësh boshnjakë që u larguan drejt republikës Federale të Kjugosllavisë apo në vende të treta dhe pjesërisht ndodhen atje edhe sot e kësaj dite.

Pas Marrëveshjes së Dayton-it, e cila i dha fund luftës civile në Bosnje-Hercegovinë dhe pas fundit të Krajina-s, statusi i provincës së Kosovës, populluar më së shumti nga shqiptarë, mbeti pas vitit 1995 çështja e fundit politike konfliktuale në luftat për shpërbërjen e Jugosllavisë. Për të gjithë udhëheqësit e shqiptarëve pavarësia nga Serbia ishte kërkesa politike kryesore. Amnesty International, në raportin e vitit 1996 tërhoqi vëmendjen në lidhje me situatën delikate të të drejtave të njeriut në Kosovë. Trazirave gjithnjë e më të dhunshme në Kosovë udhëheqja serbe nën drejtimin e Slobodan Milosevic përpërpiqej t'u jepte fund me mjete policore e në fund edhe ushtarake.

UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës), e cila operonte me mjete terroriste ,filloi në vitin 1996 të sulmonte fuqishëm forcat serbe të sigurisë. Krahas kësaj pati edhe aksione të dhunshme ndaj popullsisë civile serbe në qytete. Me pajisjen e UÇK nga rezervat e armëve të Ushtrisë Shqiptare, ku pas trazirave të firmave piramidale rendi publik u shkatërrua tërësisht dhe depo të tëra municionesh u grabitën. Ky kurs konfrontimi me forcat serbe të sigurisë u përforcua më tej, gjë të cilës iu kundërvu partia e Ibrahim Rugovës.

Pas zgjedhjeve të Presidentit Serb në vitin 1997, të cilat u bojkotuan pothuajse hermetikisht nga shqiptarët e Kosovës, situata vazhdoi të përshkallëzohej. Pas një aktiviteti të intensifikuar të UÇK, e cila gjatë vitit 1998 kishte mundur të merrte kontrollin mbi rajonin e Drenicës, forcat serbe të sigurisë nisën një kundërofensivë policore të koordinuar, e cila u mbështet nga njësi të ushtrisë dhe që u mbyll me mundjen e njërive të UÇK në rajonin e Drenicës.

Nisur nga shkelja e rëndë e të drejtave të njeriut gjatë këtyre betejave shtetet perëndimore, nën udhëheqjen e SHBA u ndjenë të thirrur në detyrimin e tyre. SHBA e konsideruan udhëheqjen serbe si fajtoreshën e vetme për përshkallëzimin e situatës dhe bënë personalisht Milosevic përgjegjës për situatën. Ndërrimi i regjimit të papërmbytur e autoritar, e të shpalluar si *persona non grata* të Milosevic ishte tanimë në sytë e perëndimorëve kushti paraprak për një paqe të qëndrueshme. Me një kërcënim të hapur ushtarak të ndërhyrjes së Aleancës së NATO-s it kundër Serbisë, SHBA arritën të merrnin kontrollin e armëpushimit përmes KVM dhe një kontroll të hapësirës ajrore përmes SHBA, gjë që do të duhej ta zbuste konfliktin por që nuk u perceptua si diçka e kënaqëshme nga SHBA si pasojë e kontrollit të Misionit nga OKB.

Pas rindezjes së përlëshjeve në pranverën e vitit 1999 NATO, nën drejtimin e SHBA, u përpoq t'i impononte udhëheqjes serbe marrëveshjen e lidhur në Rambouillet të Francës, e cila në një aneks të fshehtë ushtarak përmbante pushtimin e Republikës Federale të Jugosllavisë nga trupat e NATO-s, gjë që për qeverinë serbe ishte tërësisht e papranueshme. Refuzimin e ultimatimit të pushtimit të Jugosllavisë NATO e interpretoi si *Casus Belli* dhe duke nisur nga data 24 mars 1999 avionët e aleancës perëndimore ushtarake bombarduan për 78 ditë të gjithë Republikën Federale të Jugosllavisë.

Sulmi ajror i nisur pa mandatin e OKB, cilësuar si një luftë humanitare, kishte për qëllim pushtimin e dhunshëm të një pjese të Serbisë. Shkelja e sovranitetit territorial të një vendi si dhe ndërhyrja ushtarake e alencës ushtarake perëndimore e realizuar pa mandatin e OKB përbën për një pjesë të specialistëve të të drejtës ndërkombëtare një shkelje të kësaj të drejte, ndërsa për të tjerë është e legjitimuar nga e drejta për ndihmë.

Situata e shqiptarëve të Kosovës ndërkohë u përkeqësua, pasi serbët, ndryshe nga ç'pritej nuk u tërhoqën menjëherë nga territori. Nën trysinë e bombardimeve qeveria jugosllave miratoi Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe nënshkroi *Marrëveshjen e Kumanovës*.

Era e Milosevicit

Në zgjedhjet presidenciale të datës 24 shtator 2000 si president serb u zgjodh Vojislav Koštunica, që ishte fillimi i fundit të erës së Milosevicit. Milosevic ishte deklaruar fillimisht si fitues i zgjedhjeve, por pas grevash e demonstratash disaditore të *Opozitës Demokratike të Serbisë* dhe pushtimit të Parlamentit më 5 tetor, atij iu desh të hiqte dorë. Në zgjedhjet parlamentare të dhjetorit 2000 DOS arriti një fitore dërrmuese. Në janar 2001 Zoran Đinđić u zgjodh kryeministri i ri i Serbisë. Kjo çoi ndër të tjera që Slobodan Milosevic më 29 qershor 2001 t'i dorëzohej Gjykatës Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë në Hagë. Më 12 mars 2003 Đinđić u vra në rrugë nga atentatorë të rradhëve të ish-Beretës së Kuqe.

Me miratimin e Kushtetutës së re të vitit 2003 Republika Federale e Jugosllavisë themeluar më 1992 u shndërrua në një lidhje të lirë shtetesh dhe e ndryshoi emrin e vet në Serbi dhe Mali i Zi.

Në mes të marsit 2004 shqiptarët etnikë ndërmorën akte të rënda dhune ndaj pakicës serbe që jetonte në Kosovë. Gjatë këtyre akteve u dëbuan më shumë se 4000 persona, u vranë 19, 1000 shtëpive iu vu flaka, u shkatërruan 27 kisha dhe manastire serbo-ortodoksë.

Në datën 30 mars 2004 u miratua një ligj kontrovers, përmes të cilit Republika serbe merr përsipër të zëvendësojë të gjitha shpenzimet për të paditurit përpara gjykatës ndërkombëtare për Krimet e Luftës në Hagë, por tre ditë më pas doli një urdhër, sipas të cilit ky ligj nuk vlente për familjen e Slobodan Milosevic.

Në datën 27 qershor 2004 u zgjodh një president i ri, pasi kishin dështuar një sërë përpjekjesh të tjera, për shkak të pjesëmarrjes shumë të ulët në zgjedhje. Pjesëmarrja duhej të ishte mbi 50%, kuotë kjo që nuk u arrit kurrë. Pas heqjes së pengesës të 50%-shit fitoi reformuesi liberal dhe i përkushtuar ndaj Evropës Boris Tadić nga DS kundër Tomislav Nikolić nga Partia Nacionaliste Radikale me 53,24% të votave.

Në datën 17 gusht 2004 Asambleja Kombëtare Serbe propozoi njëzëri si simbole kombëtare flamurin e hershëm mbretëror dhe himnin Boze Pravde të shek. XIX, por kjo vetëm për një periudhë të përkohshme, derisa të caktohej një zgjidhje përfundimtare. Himni dhe flamuri nga koha e Monarkisë serbe duhet të zëvendësonin simbolet e fundit komuniste. Flamuri tregon një shqiponjë të argjendtë dykokëshe, një kryq të argjendtë dhe një kurorë.

Serbia në rrugën drejt BE

Bisedimet rreth MSA, nisur më 8 nëntor 2005 mes BE dhe lidhjes ende ekzistuese të shteteve Serbi-Mal i Zi, u ndërpre në fillimisht nga BE në pranverën e vitit 2006, pasi sipas gjyqimit të BE qeveria e Beogradit nuk ishte përpjekur sa duhej për të kapur kriminelët e luftës në kërkim, Radovan Karadzic dhe Ratko Mladic. Pas përmirësimit të bashkëpunimit të Serbisë me Gjykatën Ndërkombëtare Penale për Ish-Jugosllavinë bisedimet vijuan më tej duke përfunduar më 7 nëntor 2007 me parafimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Por kjo marrëveshje duhet të nënshkruhet vetëm pasi Karadzic dhe Mladic t'i jenë dorëzuar ICTY.

Duke u kufizuar me tetë shtete anëtare, si asnjë shtet tjetër i rajonit, Serbia ka një pozitë mjaft të rëndësishme në pikëpamjen gjeostrategjike. Epërsitë e vend-shtrirjes bëjnë që gjithnjë e më shumë firma të huaja të forcojnë gjithnjë e më shumë praninë e tyre aty, sikurse ishte rasti së fundmi i gjigantit rus të energjisë Gazprom apo të prodhuesit të automobilëve Fiat. Serbia është anëtare e bashkëpunimit ekonomik të vendeve të Detit të Zi dhe i CEFTA-s.

Situata ekonomike e Serbisë

Një pjesë e mirë e valutës së hyrë në Serbi prej dekadash vjen nga serbët që jetojnë jashtë vendit, janë ndër të tjera të ardhura nga sektori i turizmit, investimet e vogla, aty këtu investime të mëdha në vend në kuadër projektesh të ndryshme ose si mbështetje për familjet e tyre. Këto përbëjnë rreth 3,5 miliardë US Dollar në vit.

Serbia bën pjesë në ato vende që aplikojnë një (*flat tax*).

Rreth 40% e të gjithë sipërfaqes së Serbisë është e shfrytëzueshme për bujqësi. Bujqësia përbën rreth 16,6% të Produktit të Brendshëm Bruto. Sipas statistikave të vitit 2002 rreth 30% e mbarë popullsisë punojnë në bujqësi.

Sektori industrial i vendit është prej vitesh në rritje. Pjesa më e madhe e sipërmarrjeve në Serbi kanë qenë shtetërore. Në mënyrë që Serbia të bëhet më tërheqëse për investimet, në vitin 2002 filloi privatizimi i këtyre firmave.

Energjia në Serbi prodhohet kryesisht nga hidrocentralet dhe centralet e qymyrit. Me nënshkrimin e Marrëveshjes rreth ndërtimit të South Stream Gas pipeline, janar 2008 në Moskë, prej së cilës 400 km do të kalojnë nëpër Serbi, në të ardhmen e afërt në këtë vend do të jetë një ndër nyjet tranzit më të rëndësishme për gazin në Evropën Juglindore. Është dukshëm një ndër projektet më të mëdha ekonomike në Serbi që prej ndërtimit të hekurudhës në shek. XIX.

Sektori i shërbimeve dominon në Serbi që prej vitit 2001 dhe përbën më shumë se gjysmën e PBB (2007 57,9% të performancës ekonomike serbe). Ky është sektori me ritmet më të shpejta të zhvillimit në ekonominë serbe.

Në Serbi ka 18 gazeta ditore, prej të cilave Politika, Blic dhe Večernje novosti arrijnë vlerët më të larta të tirazhit. Radioja Ndërkombëtare e Serbisë ka një program në 12 gjuhë, mes të cilave edhe gjermanisht, dhe mund të dëgjohet edhe në valë të shkurtra, në satelit dhe internet si Podcast.

Taktika:

Ju jeni përfaqësues/e i/e vendit Tuaj. Mbani parasysh: Qëllimi Juaj është anëtarësimi i Serbisë në Bashkimin Evropian. Pra Ju duhet të bindni partnerët Tuaj në bisedime në lidhje me pjekurinë e Serbisë për anëtarësim. Sillni në vëmendje sukseset e mëdha të punës së qeverisë dhe sqaroni planet për reformat e mëtejshme.

Serbia ka bërë hapa përpara në plotësimin e kriterëve politike. Kushtetuta e re ka hyrë në fuqi në nëntor 2006. Po kështu është miratuar edhe një ligj kushtetutor. Në janar 2007 janë zhvilluar zgjedhjet e para parlamentare sipas standardeve ndërkombëtare. E megjithatë deri në formimin e një qeverie të re në maj 2007 u shfaqën kontradikta të mprehta politike. Kjo çoi në ngadalësimin e ritmit të reformave. Qeveria e re bëri përpjekje për t'i dhënë sërish një shtytje procesit të reformave. U përmirësua kontrolli civil mbi ushtrinë. Serbia ka dhënë një kontribut pozitiv në bashkëpunimin rajonal.

Serbia ka marrë pjesë në konsultimet rreth statusit të ardhshëm të Kosovës nën drejtimin e të dërguarit special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB për Kosovën dhe vazhdon ta bëjë këtë nëndrejtimin e Troikës ndërkombëtare.

Gjithsesi vonesa konstatohen në reformën në drejtësi dhe ekziston nevoja për një kuadër të ri ligjor. Korrupsioni është shumë i përhapur.

Të drejtat e njeriut, veçanërisht ato të grave, fëmijëve dhe romëve (në tërësi të pakicave) duhet të respektohen më shumë, pasi vazhdon të ketë tensione etnike.

Serbia duhet më në fund të bashkëpunojë në mënyrë të pakushtëzuar me ICTY dhe të gjithë ata që janë në gjendje të lirë duhet të arrestohen dhe t'i dorëzohen Gjykatës Penale të Hagës, në mënyrë që bisedimet për MSA të mund të përmbyllen normalisht.

Serbia ka shënuar përparime të dukshme në ngritjen e një ekonomie tregu funksionale. Janë të nevojshme përpjekje të tjera për realizimin e reformave, në mënyrë që Serbia të mund t'i bëjë ballë në terma afatmesme presionit të konkurrencës dhe forcave të tregut brenda Bashkimit Evropian.

Janë ruajtur elementet thelbësorë të politikës ekonomike. Ekonomia vazhdon të zgjerohej fuqishëm, në vend hyn sasi e konsiderueshme kapitali, inflacioni ra, vazhdon të ruhej teprica buxhetore dhe në aspektin e shpenzimeve janë përdorur mjetet financiare të investimeve. Tregtia e jashtme dhe investimet u rritën më tej dhe integrimi ekonomik në BE bëri përpara.

Megjithatë papunësia vazhdon të jetë ende shumë e lartë dhe privatizimi duhet të vazhdojë më tej; në sektorin privat mungon aftësia konkurruese dhe dinamika.

Bisedimet rreth MSA treguan se Serbia disponon kapacitetet e nevojshme administrative për të ardhur më afër anëtarësimit në BE. Kushtet për zbatimin e MSA në Serbi janë të mira. Në sektorë të tillë si qarkullimi i lirë i mallrave, doganat dhe tatimet, industri dhe SME, bujqësi dhe politika e vizave, Serbia ka bërë progres të mirë. Gjithashtu ajo ka ndërmarrë edhe përpjekje të tjera për të përmirësuar aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet që do të rridhnin nga anëtarësimi. Gjithsesi vendi ka ende pika të dobëta të konsiderueshme për të eliminuar në zbatimin e efektshëm të dispozitave ligjore. Mungesa të veçanta ka në sektorin e personelit dhe të burimeve financiare.

Turqia [Türkiye]

Kryeqyteti:	Ankaraja (3,6 Mln. banorë) (të dhëna të vitit 2004)
Forma shtetërore:	Republikë, demoktraci parlamentare
Sipërfaqja:	779.000 km ²
Banorë:	72,975 Mln.
PBB/ banor:	5.400 US-Dollar
Rritja ekonomike	6,1%
Papunësia:	9,9%
Gjuhët:	turqisht, dialekte kurde
Besimi fetar:	muslimanë rreth 99%, nga këta pjesa më e madhe Henefitë (sunist, „ortodoksë“ me origjinë nga islami përkrah këtyre Alevitë („heterodoksë“ drjetim i Islamit) rreth 15-20 Mln.; të krishterë armenë-apostoliskë rreth 65.000, ebre rreth 25.000, orthodoxe sirianë 15.000
Grupe etnike:	80% turq, 20% kurdë (hamendje)
Kryetar shteti:	Ahmet Noedet Sezet
Kryetar qeverie:	Recep Tayyip Erdogan
Informacione të mëtejshme:	www.tuerkischebotschaft.de

www.weltalmanach.de (2009)

Ju jeni përfaqësuese/përfaqësues i Turqisë. Në vitin 1987 vendi juaj ka parashtruar kërkesën për antarësim në Bashkimin Europian. Duke patur parasysh këtë periudhë kohe të gjatë ju kërkoni pranimin e shpejtë në Union. Gjatë bisedimeve mund t' i referoheni të dhënave të mëposhtme nga historia, politika dhe ekonomia e vendit tuaj. Natyrisht që disa të dhëna jo të volitshme mund të fshihen ose të përmirësohen.

Historia

Historia e Turqisë si shtet republikan filloi në vitin 1923. Me anë të një sërë aksionesh të dhunëshme revolucionare kulturore, Mustafa Qemal „Ataturk“ u mundua të krijonte një shtet modern sipas shëmbullit perëndimor. Koncepti „Kemalizmus“ u kristalizua përgjatë kësaj në gjashtë principe të cilat u bënë pjesë e progrmit të partisë shtet „Partia Popullore Republikane“ (CHP), themeluar nga Ataturku në vitin 1943. Ato janë: Nacionalizmi (krijimi i një shteti kombëtar turk), Shekullarizimi (Laicizmi, d.m.th. ndarja e shtetit nga feja dhe shkëputja nga ideja e Pernadorisë Islamike), Republikanizmi (zgjedhja e formës qeverisëse republikane dhe anulimi i rivendosjes së sundimit sulltanor dhe kalifat), Populizmi (barazi e qytetarëve pa dallim përkatësie popullore, gjuhe dhe besimi njëkohësisht „vullneti i popullit“ duhet të njihej si element konstruktiv i shtetit turk), Etatizmi (rol i përcaktuar i shtetit në ekonomi), Reformizmi (postulat i një shëndrrimi dinamik permanent i shtetit dhe shoqërisë).

Që prej reformave të Ataturkut, Turqia zhvillon një proces riorientimi i cili është aq përfshirës, radikal dhe megjithë rrëniet ekonomike- aq i qëndrueshëm sa në asnjë vend tjetër islamik. Përpjekja e integritit në Evropën Perëndimore shoqërohet ende sot me masa demokratike siç ishte edhe ajo e gushtit 2002 në lidhje me ndryshimet në Kushtetutë.

Zhvillime politike të reja

Në datën 3 nëntor 2002 u zhvilluan në Turqi zgjedhjet e përgjithëshme të parakohëshme. Partia e re në Qeveri, AKP-ja (Partia e të Drejtës dhe Zhvillimit), një parti qendrore e djathtë, shprehu shumë qartë qëndrimin e saj kundrejt reformave dhe shpalli si qëllim të saj plotësimin e kriterëve politike të Kopenhagenit për t'i hapur rrugën nisjes së bisedimeve për anëtarësim me BE-në.

Partia në opozitë, Partia Popullore Republikane, parti qendrore e majtë mbështet qëndrimin e Qeverisë në lidhje me procesin e anëtarësimit të Turqisë. Megjithatë mbetet e hapur pyetja se deri në çfarë pike një shoqëri e cila në pjesën më të madhe të saj i ka rrenjët në tradita islamike, ku dhe gjen sigurinë, orientimin dhe identitetin, do të mbështesë pikëpamjet e një elite me tendenca perëndimore.

Kjo u pasqyrua edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 të cilat i detyroheshin parimit të lira-demokratike por gjatë të cilave shumica e votuesve votuan për Partinë Islamike.

Zhvillimi i mëtejshëm i vendit luan rol të madh në vendimmarrjen për anëtarësim në BE çka momentalisht po diskutohet në mënyrë veçanërisht kontroverse nga vendet antare. Gjermania, e cila tradicionalisht ka patur marrëdhënie të mira me Turqinë e ndjek me interes të veçantë këtë çështje pasi emigrantët me origjinë turke përbëjnë me 2,4 milionë banorë, një minoritet të madh etnik.

Kodi i ri civil që hyri në fuqi më 1 janar 2002 shënoi një kthesë në përpjekjet e Turqisë për përshtatjen me standartet e BE-së pasi në këtë kod u ndërmorrën ndryshime domethënëse nga fusha e barazisë së të drejtave, mbrojtja e fëmijëve dhe pjesës së dobët të shoqërisë si dhe lirisë së bashkimit.

Qeveria turke miratoi gjithësej shtatë „Paketa harmonizimi“ të cilat kanë hyrë në fuqi nga 19 shkurti i vitit 2002 deri më 7 gusht të vitit 2003. Në vitin 2001 u përafëruan 34 nene të Kushtetutës turke me legjislacionin evropian. Ndryshimet e Kushtetutës në datë 3 tetor 2001 i përkisnin lirisë së mendimit dhe fjalës, mbrojtjes nga tortura, përforcimit të demokracisë dhe zyrave civile, lirisë së sigurisë së individit, të drejtës për sferë private si dhe lirisë së lëvizjes, lirisë për bashkim dhe barazi gjinore.

Sfida të madhe përbën tashmë zbatimi në praktikë i këtij numri të madh ndryshimesh ligjore. Në lidhje me këtë vihen re vazhdimisht mungesa të mëdha, veçanërisht tek zbatimi i ndalimit të torturës dhe, duke hedhur vështrimin tek popullsia kurde, tek zbatimi i mbrojtjes efektive të së drejtës së minoritetit. Për këtë arsye BE-ja në mënyrë të përqëndruar kontrollon fuqimisht nëse ligjet turke japin rezultat në jetën e përditshme.

Për sa i përket reformave politike të vitit 2007 sukseset kanë qënë të pakta.

- Hapa të mëdha përpara duhen bërë në lirinë e fjalës dhe të drejtave të komuniteteve jo myslymane.
- Përpjekje të tjera shtesë janë të nevojshme në sektorin e luftës kundër korrupsionit, në sistemin e drejtësisë, të drejtat për sindikatat, për fëmijët dhe gratë, për të drejtat kulturore si dhe në sektorin e kontrollit civil mbi forcat e sigurimit.
- Qeveria e re duhet të aktivizohet pa humbur kohë në këto sektorë prioritarë.
- Në lidhje me çështjet më urgjente, pikërisht me lirinë e mendimit dhe lirinë e fesë, Qeveria duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm.

- Sulmet terroriste të PKK-së e cila ndodhet në listën e organizatave terroriste të BE-së, janë rritur në numër. Ka një domethënje vendimmarrëse që Turqia dhe Iraku përmes një bashkëpunimi të zyrove përkatëse të mund t'a trajtojnë këtë problem në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.
- Turqia duhet t'i gjejë zgjidhje problemeve serioze ekonomike dhe sociale në juglindje të vendit. Përveç kësaj Turqia ka ruajtur kufizimet e lidhjeve direkte të qarkullimit me Qipron.

Ekonomia

Vetëm në disa dhjetëvjeçarë ekonomia turke u zhvillua nga një ekonomi pothuajse vetëm agrare-bujqësore në një ekonomi strukturore të diferencuar, e cila karakterizohet nga ndryshime të forta midis perëndimit dhe lindjes së vendit. Edhe sot, më shumë se 40 përqind e të punësuarve janë aktivë në sektorin bujqësor dhe japin një kontribut prej rreth 13 përqind të Prodhimit Social Bruto. Krainat në lindje dhe juglindje të vendit krahsueshërisht të pazhvilluara kanë një infrastrukturë agrare. Përqëndrimi në sektorin agrar përbën një nga pikat kryesore të diskutimit në lidhje me një anëtarësim të mundshëm në BE. Shtetet antare aktuale kanë frikë se rritja e subvencioneve evropiane për sektorin agrar në Turqi mund të kapërcejë kuadrin financiar të Komunitetit. Mbi të gjitha në Turqinë Perëndimore vihet re dukshëm një zhvillim industrial (tekstile, automjete, kimi, makineri, sektori elektronik), industria ndikon me 25 përqind PSB-në.

Në vitin 2002 dhe 2003 ekonomia filloi të rimerrej nga recesioni i vitit 2001. Motor i zhvillimit ekonomik ishin në rradhë të parë eksportet edhe rimbushja e rezervave. Kërkesa e brendshme ka filluar që prej pak kohësh të tërheqë përsëri dhe trysnia e inflacionit ka rrënë.

Interesi real i përqindjes vazhdon të jetë i lartë dhe papunësia është rritur, në tremujorin e dytë të vitit 2003, 9,3 përqind më shumë se një vit më parë.

Shkalla e papunësisë lëviz midis 13,2 përqind në zonat urbane dhe 6,3 përqind në zonat rurale. Papunësia tek moshat e reja është rritur me 20 përqind. Edhe pse në vitet e shkuara diferenca e pagave u ashpërsua ndjeshëm u mundësua zbutja e stabilizimit absolut të varfërisë.

Megjithëse Qeveria e re në 2002 paralajmëroi një mbështetje të gjërë të reformave të domosdoshme strukturore, ritmi i reformave ekonomike që prej asaj kohe është ngadalësuar dukshëm. Shkak për këtë ishte në rradhë të parë organizimi me përparësi i reformave në sektorin politik dhe kriza në vendin fqinj, Irak.

Përpyekjet turke për reforma mbështeten teknikisht dhe financiarisht nga FMN-ja dhe Banka Botërore; huatë e akorduara nga FMN-ja dhe Banka Botërore përbëjnë më shumë se 10 përqind të PSB-së.

Marrëdhënjet midis Bashkimit Evropian dhe Turqisë

Përfshirja në Bashkimin Perëndimor filloi për Turqinë me deklaratën e luftës Gjermanisë në vitin 1945. Kjo krijoi kushtin për tu bërë antar themelues i NATO-s. Doktrina e Trumanit e vitit 1947 i garantoj Turqisë dhe Greqisë integritet kombëtar dhe sovranitet të cilat ishin me shumë rëndësi për sigurinë e ShBA-së. Kjo i hapi rrugën mbështetjes së

madhe perëndimore në sektorin ekonomik dhe ushtarak. Në datë 18 shkurt 1952 Parlamenti turk me shumicë votash miartoi anëtarësimin në NATO.

Turqia ka qënë një nga themeluesit e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik në Evropë (OEEC) dhe në gusht të 1949 – sëbashku me Greqinë u antarësua në Këshillin e Evropës. Që në vitin 1964, Komuniteti i atëhershëm Ekonomik Evropian (EWG) rakordoi një marrëveshje asociimi me Turqinë. Neni 28 i kësaj marrëveshjeje i hap Turqisë perspektivën për anëtarësim në Komunitetin Evropian. Pas këtij hapi nuk pati më asnjë tentativë tjetër afrimi midis Evropës dhe Turqisë. Në vitin 1987 Turqia bëri kërkesën për anëtarësim të plotë e cila u rrëzua në vitin 1990.

Në dhjetor të vitit 1995 Bashkimi Evropian formoi një Bashkim Doganor me Turqinë. Ky Bashkim heq çdo tarifë doganore midis BE-së dhe Turqisë dhe vendos një tarifë të jashtme doganore të përbashkët.

Në mars të 1998 Komisioni aprovoi "Strategjinë evropiane për Turqinë". Kjo strategji përmban propozime për përforcimin e bashkëpunimit në nivel dypalësh. Nga ana e saj Turqia u shpreh dakort me tekstin e Komisionit Evropian tek "Strategjia për Zhvillimin e Marrëdhëneve midis Turqisë dhe BE-së – Propozimet e Turqisë".

Në Këshillin e Evropës në Helsinki, në dhjetor 1999, Turqia u njoh më në fund si kandidate formale për anëtarësim. Kjo mundësoi një kthesë të rëndësishme në këto marrëdhënie e cila i dha fund periudhës së akullt. Marrëveshja mbi Partneritet për Anëtarësim me Turqinë u nënshkrua gjatë samitit të BE-së në Nica, në dhjetor të vitit 2000. Që prej vitit 2000, Turqisë i akordohet nga Bashkimi Evropian mbështetje para-anëtarësimi.

Në 19 mars 2001, Qeveria turke miratoi programin e saj kombëtar për zbatimin e partneritetit për anëtarësim. Ky program reformash ka për qëllim të krijojë një situatë në vend e cila përmbush kriteret e Kopnhagenit mbi të cilat bazohet procesi i zgjerimit. Një zyrë e Sekretariatit të Përgjithshëm të BE-së është krijuar tëshëm në Turqi. Turqia ndodhet kështu në fillimet e revizionit fundamental të gjithë sistemit politik, ekonomik dhe social. Megjithë ringjalljen e marrëdhënieve midis Turqisë dhe BE-së vazhdojnë ende të ekzistojnë probleme midis dy partnerëve.

Që prej vitit 1998, situata e përgatitjeve të Turqisë paraqitet në formën e një raporti vjetor përparimesh i cili klasifikohet dhe vlerësohet nga Komisioni Evropian. Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian kriteret e Kopnhagenit me disa përjashtime, janë përmbushur. Kritika vazhdon të ketë në lidhje me zhvillimet në sektorin e demokratizimit, shtetit ligjor dhe të drejtave të njeriut.

Edhe njohja dhe zbatimi i të drejtave të përcaktuara (kulturore) për minoritetin kurd në vend nuk janë plotësuar. BE-ja i ka premtuar Turqisë hyrjen në bisedime për anëtarësim vetëm në qoftë se vendi arrin të përmirësojë mungesat e konstatuara.

Këto bisedime duhet të zhvillohen të hapura kundrejt rezultatit, d.m.th. një antarësim i Turqisë nuk është ende çështje e sigurt. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit dhe luftës në Irak, Turqia forcohet në rolin e saj të rëndësishëm gjeostrategjik. Vendi e sheh veten si një urë midis Evropës dhe Botës Islame dhe si partner të rëndësishëm të Perëndimit në luftën kundër terrorizmit fundamentalist. Në këtë kontekst bashkëpunimi midis Turqisë dhe BE-së është i një rëndësie elementare. Edhe për ShBA-në Turqia është një partner i rëndësishëm. Si pasojë e sulmeve terroriste, Turqisë mund t'i kërkohej gjithmonë në lidhje me anëtarësimin në BE, një aktivizim më i madh.

Me pranimin e Qipros në BE marrëdhënia armiqsore historike midis Turqisë dhe Greqisë nuk është përmirësuar. Mosmarrëveshjet në lidhje me kufirin në zonën detare si dhe pikëpamjet e kundërta për sa i përket ishullit të Qipros (pjesa jugore greke e Qipros është anëtarësuar në BE në vitin 2004, pjesa veriore republikane njihet vetëm nga Turqia dhe mbrohet nga trupat turke) i rëndojnë marrëdhëniet.

Përafrimi i Turqisë me BE-në vë si kusht edhe qëndrimin konstruktiv të Ankarasë përballë çështjes së Qipros. Kushti i BE-së për fillimin e bisedimeve për njohjen nga ana e Turqisë së pjesës greke të Qipros si shtet, nuk është realizuar ende. Megjithatë duhet marrë parasysh se ribashkimi i ishullit i këshilluar nga OKB-ja dështoi jo për shkak të qipriotëve turq por nga vota negative e qipriotëve grekë.

Shumë debate mbi anëtarësimin e mundshëm të Turqisë gjatë viteve të fundit janë krijuar nga situata jo shumë racionale dhe objektive. Debatet mbi anëtarësimin e Turqisë në BE në Republikën Federale të Gjermanisë ashtu si edhe në vende të tjera të BE-së influencohen nga vështirësitë e brendshme politike dhe ekonomike nga njëra anë dhe nga ana tjetër nga pengesat e dala gjatë procesit të reformave ekonomike dhe politike brenda në BE. BE-ja ndodhet në një krizë të thellë çka lidhet direkt me programin e saj politik, vendosjen e qëllimeve dhe zbatimin e tyre.

Këto çështje pasqyrohen në diskutimet mbi problemet e ndryshme që mund të rezultojnë nga anëtarësimi i Turqisë në BE. Në thelb qëndrojnë vetëm mëdyshje të friksuara,

- se ndërmjet kësaj procesi politik dhe ekonomik i bashkimit dhe zhvillimit në BE mund të bllokohej sërisht.
- se mbështetja ekonomike për Turqinë do të rëndonte financiarisht BE-në.
- se ndryshimet kulturore të Turqisë nuk janë të shëndetshme për zbatimin dhe përforcimin e vlerave evropiane.

Një vend i ri anëtar me potenciale, zhvillimi demograf i të cilit përmbys tendencën e një popullsie me ulje në numër dhe plakje, i cili megjithë rritjen ekonomike të konsiderueshme dhe ruajtjen e nivelit të varfërisë në nivelin 25%, popullsia e të cilit mbështet dukshëm demokracinë edhe pse me dy të tretat dëshëron një figurë politike të fortë, përbën një nxitës për debate të ashpra. Shpesh këto debate janë më shumë ideologjike se sa të mbështetur mbi të dhëna konkrete, fakte dhe kërkime objektive.

Arritja e një konsensusi është megjithatë e mundur – pikërisht atje ku sukseset janë të matshme si për shëmbull në nivelin e rentabilitetit të anëtarësimit në BE të Turqisë si dhe në reforma të prekshme në sistemin politik dhe atë të drejtësisë dhe ndryshime të mëtejshme, ashtu siç kanë ndodhur gjatë viteve të fundit në Turqi. Për sa i përket Republikës Federale të Gjermanisë si partneri kryesor tregtar i Turqisë, avantazhet ekonomike janë të dukshme.

Problem të veçantë përbën natyrisht debati në lidhje me identitetin e supozuar evropian i cili nuk qëndron i hapur ndaj Turqisë. Këtyre diskutimeve mbi vlera dhe parime – ashtu siç ato zhvillohen nga vendet anëtare – i mungon baza pothuajse objektive kulturore-historike, gjeografike ose dhe politike në Marrëveshjen e Bashkimit Evropian. Turqisë i janë vënë pjesërisht kritere që deri më tani nuk ishin parashtruar për asnjë shtet tjetër kandidat.

Edhe brënda në Turqi anëtarësimi në BE shihet me pikëpyetje. Jo vetëm nga pikëpamja ekonomike janë zgjuar shpresa- por edhe minoritetet etnike dhe fetare shpresojnë në mbështetjen e Brukselit. Njëkohësisht një pjesë e mirë e popullsisë ka frikë nga „Qeveria Evropiane“ në Bruksel.

Taktikë:

Si përfaqësues/përfaqësues i Turqisë gjatë argumentimit tuaj reforjuni faktit se ky vend përfaqëson urën për në Islam, për në ish Bashkimin Sovjetik dhe Azinë Qëndrore. Të drejtën për anëtarësim të shpejtë në BE e justifikoni me kërkesën për anëtarësim parashtruar shumë vite më parë.

Vini theksin në rradhë të parë mbi avantazhet e politikës për sigurinë që ka BE-ja nëpërmjet anëtarësimit të Turqisë. Bëni të qartë se, në rast rrezimi të kërkesës, Turqia kërcënohet nga një qëndresë e forcave nacionaliste dhe fondamentaliste çka nuk mund të jetë në interes të BE-së.

Njëkohësisht duhet të shfuqizoni pretendime të shteteve antare në BE të cilët kanë frikë nga rritja e tensionit midis Greqisë dhe Turqisë duke klasifikuar anëtarësimin e mundshëm të Turqisë në BE me rrezikshmëri të lartë për BE-në në rajonet e mesdheut. Atëherë për sa i përket integritet në politikën e përbashkëta të sigurimit dhe mbrojtjes tregohuni i hapur. Ju e dini se një pjesë e madhe e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përshëndesnin bashkimin e Turqisë në këtë strukturë me siguri relevante.

Në lidhje me konfliktin në Qipro: Mbani qëndrim diplomatik dhe mbështetni një zgjidhje të drejtë në interesin tuaj për konfliktin në Qipro (Themelimi i një Konfederate me të drejta të barabarta dhe njohja në shkallë ndërkombëtare e Qipros Veriore). Ju jeni të gatshëm për kompromise por edhe BE-ja dhe në veçanti Greqia dhe Qipro duhet të paraqesin propozimet e tyre. Nënvizoni se çështja e Qipros është problem dypalësh dhe se nuk mund të zgjidhet vetëm nga pala turke. Edhe në lidhje me mosmarrëveshjet për çështjen e kufirit me Greqinë kërkoni një zgjidhje me mirëkuptim.

Referojuni rolit të rëndësishëm politik dhe ekonomik që luan Turqia si vend mesdhetar. Munduhuni të fitoni si mbështetës të kërkesës suaj për anëtarësim vendet e tjera mesdhetare (Spanjën dhe Italinë). Përveç Greqisë, edhe Bullgaria e sapo antarësuar është fqinji juaj direkt dhe brenda mundësive mbështetësi juaj.

Duke qënë se i njihni kundërshtimet për një anëtarësim të shpejtë (pika reference: mungesa e demokracisë, situata e kurdëve, numri i madh i të punësuarve në vendet e BE-së veçanërisht në Gjermani) ofroni kompromise për të mundësuar anëtarësimin e plotë. Kështu, në rast të një anëtarësimi të plotë mund të kërkoni për një kohë të paktuar kufizimin e lirisë së lëvizjes së turqve për të ulur frikën e mundshme të partnerëve të BE-së nga punëmarrëse/punëmarrës të shumtë turq. Përgatituni se shumë vende anëtare do të përdorin si argument kundër anëtarësimit të vendit tuaj „ndryshimet e mëdha kulturore“ midis Turqisë dhe Evropës. Kundërshtoini ata duke thënë se Evropa është një komunitet vlerash i cili bazohet në principet e larmisë kulturore dhe tolerancës dhe se anëtarësimi i Turqisë do t'i jepte më shumë nota këtyre principeve.

Në përfundim shprehni shqetësimin tuaj se si rrjedhojë e një rekomandimi negativ të Komisionit të BE-së, marrëdhëniet turke- evropiane do të rrezikohen dhe se rrymat fondamentaliste mund të forcohen.

Interesin tuaj drejtojeni veçanërisht pozicionit gjerman në Këshillin e Bashkimit Evropian. Për shkak të lidhjeve në përgjithësi të ngushta midis dy vendeve, Turqia pret mbështetje aktive nga pala gjermane në lidhje me anëtarësimin turk në BE. Gjermania është partneri më i rëndësishëm tregtar dhe nga investimet më të mëdhenj në Turqi. Në Gjermani jeton një minoritet turk; pothuajse rreth 40.000 sipërmarrës turq japin në mënyra të ndryshme kontributin e tyre në ekonominë politike federale gjermane, si p.sh. hapin vende të reja pune.